



Stefan Joss: Prioritet edukimi profesional, kërkimi shkencor dhe punësimi në sektorë të ndryshëm si në bujqësi, teknologji apo turizëm

Faqe 3



RisiAlbania mbështet të rinjtë në përpjekje për të punuar dhe jetuar në Shqipëri

Faqe 2



MBZHR nxit të rinjtë për sipërmarrje në bujqësi: Aplikoni në skemat mbështetëse

Faqe 5



AGROBIZNESI

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i dytë i muajit dhjetor 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 452
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

STRATEGJIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE 2023-2030

PUNËSIMI DHE AFTËSITË NË FUSHËN E EKONOMISË SË USHQIMIT, BUJQËSIA SEKTORI QË ANGAZHON NË PUNË PJESËN MË TË MADHE TË SHQIPTARËVE, ME 33.8% TË TË PUNËSUARVE

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj prezantoi në Këshillin Kombëtar të Punës, Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030. Ajo tha: "Po ngrihen disa komitete sektoriale, për diskutimin e problematikave në sektorë të ndryshëm. Pas turizmit dhe IT-së, jemi në përgatitje të një komiteti të tretë për fushën e bujqësisë".


RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Sa vlerësohen fermerët e certifikuar?

Andon Rrapokushi
Menaxher i Sigurisë Ushqimore



Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri



Faqe 2



HISTORI SUKSESI

Sipërmarrësja e re me mbështetjen e IPARD ngriti pikën e grumbullimit në Kavajë



Faqe 6

KËNDI I EKSPERTIT

- Kujtesë këshilluese për fermerët që kanë mbjellë grurë Fq.11
- Kullimi i tokave bujqësore dhe masat që merren për funksionimin e tij Fq.11
- Cilat janë kriteret që duhet të plotësojë prodhuesi për të ngritur një fermë shpendësh, sistemet e mbajtjes dhe menaxhimi i tyre Fq.12
- Kalendari bujqësor, muaji janar 2023 - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

Krifca me homologun italian: Ndihamojmë fermerët të dalin në tregje ndërkombëtare, program i veçantë për vajin e ullirit



Faqe 2

SUBVENCIONIM

Mbi 5 mijë blegtorë, përfitues nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në bujqësi



Faqe 10


RISI ALBANIA

BASHKËPUNIM

Sa vlerësohen fermerët e certifikuar?

Andon Rrapokushi, Menaxher i Sigurisë Ushqimore

Opsioni 2 i certifikimit në grup të fermerëve është modeli që me të drejtë po promovohet 3-4 vitet e fundit si opsioni më i mirë për certifikimin e frutave dhe perimeve. Doni Fruits zba-



ton prej katër vitesh këtë opsion për certifikimin GlobalGAP në bashkëpunim me RisiAlbania. Përvoja 4-vjeçare e kësaj kompanie (e cila aktualisht mban certifikatën GlobalG.A.P për 8 produkte) tregon se ky proces nuk mund të realizohet me sukses pa një strukturë të posaçme që quhet Qendra e Menaxhimit të Cilësisë (QMS – Quality Management System), e cila menaxhon të gjithë procesin. Menaxheri që e drejton, një inspektor i brendshëm, një auditor i brendshëm dhe agronomi, të cilët plotësojnë kriteret profesionale për të përmbushur detyrat përkatëse, përbëjnë QMS.

Parë nga optika e vendeve më të zhvilluara europiane, në realitetin e sotëm të eksporteve të fruta-perimeve nuk mund të ecësh përpara dhe të jesh i suksesshëm pa produkte të certifikuar. Dhe kompanitë kryesore eksportuese shqiptare, që synojnë gjithmonë tregjet më të mira, më fitimprurëse, e kanë kuptuar shumë mirë këtë. Prandaj edhe investojnë për certifikimin, organizojnë fermerët në grup, paguanjnë faturën e certifikimit dhe shpenzime të tjera të domosdoshme që nuk janë pak.

Por a bëjnë kompanitë grumbulluese dhe eksportuese mjaftueshëm për fermerët që certifikohen? Përgjigja është JO! Në nivel fermeri të certifikuar dhe në nivel vlerësimi të të gjithë grupit, bëhet shumë pak, po të marrim në konsideratë faktin që këta fermerë prodhojnë produkte të shëndetshme me cilësi të lartë. Çfarë duhet bërë nga këto kompani? Është e nevojshme të bëhet dallimi në vlerësim ndërmjet dy kategorive të fermerëve furnitorë: ndërmjet fermerit të certifikuar dhe atij të pacertifikuar. Përmendim këtu që një nga pikat e kontrollit të GlobalG.A.P. është ajo që produktet e certifikuar duhet të jenë të ndara nga ato të pacertifikuar, të mos përzihen me njëri – tjetrin, gjë që tregon rëndësinë dhe ka lidhje me gjurmueshmërinë e produktit.

Së pari, duhet një diferencë në çmim në favor të fermerit të certifikuar, psh minimumi 10 lek/kg. Së dyti, të ketë prioritet në shlyerjen e pagesave për fermerët e certifikuar, duke eliminuar vonesat, sidomos ato të tejzgjatura.

Nëqoftëse nuk bëhet diferencim, nëqoftëse fermeri i certifikuar shikon të njëjtin trajtim si shoku i tij i pacertifikuar nga Pika e Grumbullimit, apo edhe më ulët, atëherë përse i duhet një proces certifikimi kaq strikt si GlobalGAP? Interesi i tij për certifikimin zbehet.

Grupi Kombëtar Teknik i Punës, NTWG, ka bërë dhe vazhdon të bëjë një punë të mirë për sensibilizimin dhe nxitjen e certifikimit GlobalG.A.P. dhe në listën e subvencioneve të Ministrisë së Bujqësisë është shtuar edhe mbështetja financiare për këtë standart. Por fjala këtu është për pikat e grumbullimit dhe të eksportit, duke qenë ato direkt të lidhura me domosdoshmërinë e certifikimit të produkteve.

Grupi i fermerëve të certifikuar përbën një institucion për çdo kompani eksportuese që zbaton standardin GlobalG.A.P., që i shton vlerën dhe reputacionin asaj kompanie, fermerët e certifikuar i mundësojnë kompanisë të arrijë tregjet me vlerë të lartë, siç janë ato të Gjermanisë, Zvicrës etj. Duke prodhuar produkte me standarde të larta cilësie, ky grup kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin dhe forcimin e sigurisë ushqimore dhe është faktor në rritjen e eksporteve të fruta-perimeve.

Çështja është: a shikohet si institucion ky grup prodhuesish, i krijuar për një qëllim specifik siç është certifikimi, si një vlerë e kompanisë eksportuese? Prandaj drejtuesit e pikave të eksportit që janë futur apo do të futen në procesin e certifikimit me opsionin në grup, duhet t'i kushtojnë më tepër vëmendje fermerëve anëtarë të grupit GlobalG.A.P. E thënë më shkëlqor, fermerët e certifikuar duhet të ndjejnë dhe të prekin vlerësimin, të jenë prioritet i kompanisë grumbulluese dhe eksportuese në blerjen e produkteve dhe në çmim, sigurisht pa e absolutizuar, por diferenca duhet të ndodhë. Përndryshe përse do t'i duhet fermerit t'i futej këtij procesi jo të lehtë, me procedurë, monitorime, inspektime dhe auditime kur ai nuk do të shihte përfitimet nga ky certifikim? Më tepër se fjalët dhe premtimet që thuhet, vlerësimi veprimet konkrete.

Problemi tjetër është ai në lidhje me numrin e fermerëve të përfshirë në proces certifikimi: ai është shumë i vogël në krahasim me numrin e fermerëve furnitorë të pikave të grumbul-

limit dhe të eksportit. Psh, aktualisht grupi GlobalG.A.P. i Doni Fruits ka 52 fermerë nga rajone të ndryshme të Shqipërisë, i cili përbën vetëm 3,3% të numrit të përgjithshëm të fermerëve furnitorë. Shumë pak për të pretenduar se kemi arritur standardin GlobalG.A.P. në shkallë të gjerë. Por nga ana tjetër, procesi nuk është i lehtë. Prandaj ajo përvojë që është arritur me këtë grup prej 52 vetash duhet ta promovojmë, ta ndajmë, ta bëjmë të njohur tek fermerët e tjerë, edhe tek ata që nuk janë pjesë e grupit, që fermerët e pacertifikuar të shohin diferencën konkretisht. Ndonëse ndarja e eksperiencave pozitive të kultivimit të perimeve sipas procedurave GlobalG.A.P. nuk bëhet aq sa duhet edhe brenda vetë grupit, kur ajo është bërë gjatë këtyre 4 viteve, ka patur një impakt shumë pozitiv.

Veprimtaritë teorike të ndërthurura me praktikën në sera ose në fushë të hapur, me demonstrime të teknologjive dhe eksperimente të varieteteve të reja ndihmojnë në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet prodhuesve dhe në drejtim të realizimit të një procesi të suksesshëm certifikimi në grup. Veprimtari të tilla janë zhvilluar me fermerët të certifikuar në Hygjiokaj të Lushnjes dhe në Moravë të Beratit.

Në procesin e certifikimit GlobalG.A.P. rëndësi ka përzgjedhja e fermerëve – anëtarë në rastin e pikave të grumbullimit. Fermerët duhet të jenë kultivues të mirë, të kenë pasion punën që kryejnë dhe të jenë bashkëpunues e mëndje hapur. Nga ana tjetër, duke qenë një proces me standart të lartë dhe me kërkesa të forta, që përfshin të gjithë pjesën e zinxhirit të ushqimit në nivel ferme, jo të gjithë fermerët janë të gatshëm ta përqafojnë dhe zbatojnë atë. Prandaj duhen gjetur dhe përdorur edhe forma alternative për të rritur numrin e fermerëve që angazhohen për të përmirësuar cilësinë dhe për të prodhuar produkte të pastra dhe të shëndetshme. Një nga këto alternativa është standarti localG.A.P., i cili është më i thjeshtë dhe po promovohet edhe nga grupi teknik NTWG Albania.

Më sipër u fol vetëm për fermerët e certifikuar si pjesë e grupit GlobalG.A.P. Por pjesë e këtij procesi certifikimi mund të jenë edhe njësitë e paketimit të produkteve (PHU – Project Handling Units), siç është rasti i Doni Fruits. Por kjo kërkon një analizë tjetër në kuadrin e certifikimit, që përfshin shumë elementë të tjerë të rëndësishëm, si procedurat e pranimit të mallit, të ruajtjes dhe të seleksionimit, paketimit dhe etiketimit, gjurmueshmërisë, higjienën dhe kushtet e punës së punëtorëve etj.

Krifca me homologun italian: Ndhimmojmë fermerët të dalin në tregje ndërkombëtare, program i veçantë për vajin e ullirit

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca gjatë vizitës zyrtare në Romë, u prit në takim nga ministri i Bujqësisë dhe Sovranitetit të Ushqimit, Francesco Lollobrigida me të cilin diskutuan mundësinë e rritjes së prezencës së produkteve shqiptare në tregun italian.

Lidhja direkte e pikave të grumbullimit me hipermarketet italiane për fruta dhe perime ishte një nga temat kryesore ku u fokusua biseda.

Takimi mes dy ministrave solli në diskutim edhe rritjen e potencialit të bashkëpunimit për ullirin, një kulturë që ka mjaft zhvillim në vendin tonë vitet e fundit, shoqëruar me prodhim të mbarë dhe rritjen e kapaciteteve përpunuese për vajin e ullirit. Ministri italian Francesco Lollobrigida theksoi se Italia ka nevojë për tregje ku të blejë ullirin dhe vajin e përpunuar, dhe prodhimi shqiptar i

plotëson kërkesat e kompanive italiane.

Ndërkohë ministrja Krifca krahas angazhimit për të lidhur

turë prodhimi shumë të rëndësishme për Shqipërinë.

Takimi vjen pas bisedimeve pozitive mes kryemin-



prodhuesin shqiptar meblerësin italian kërkoi dhe afrimin e ekspertizës teknologjike italiane për përpunimin cilësor për prodhuesit vendas në një kul-

istrit Rama dhe kryeministres së Italisë Giorgia Meloni në samitin mes Bashkimit Europian dhe Ballkanit Perëndimor që u zhvillua në Tiranë.

RisiAlbania mbështet të rinjtë në përpjekje për të punuar dhe jetuar në Shqipëri

RisiAlbania po mbështet të rinjtë në përpjekje për të punuar dhe jetuar në Shqipëri. Ky projekt po ofron support në disa programe të rëndësishme për të rinjtë shqiptarë, për angazhimin e tyre në punë në disa nga sektorët potencialë të ekonomisë së vendit si agrobiznes, turizëm, teknologji e inovacion.

Përmes krijimit të Zyrës së Këshillimit të Karrierës, RisiAlbania synon të zbatojë një

të qeverisë shqiptare, po prezantojnë skemën e garancisë rinore, e cila do të merret kryesisht me formimin dhe arsimin profesional të të rinjve si dhe me punësimin e tyre. “Është shumë e rëndësishme, thonë ata, që arsimi dhe formimi profesional të përdoren si një motor për të gjetur mundësi për të rinjtë dhe jo si një zgjedhje dytësore për ta”.

Të rinjtë, është e rëndësishme që të mos largohen nga

të formëzohet mundësi dhe perspektiva për rininë rurale. Kjo zyrë është pjesë e një projekti të RisiAlbania, ku të rinj nga zona të ndryshme kanë ardhur dhe kanë paraqitur idetë e tyre, apo janë këshilluar për rrugën që duhet të ndjekin në drejtim të punësimit të tyre dhe kontributit për familjet dhe vendin e tyre.

Të rinjtë, që kanë kontaktuar Zyrën e Këshillimit të Karrierës, kanë përfituar mbështetje



strategji në angazhim, ndërlidhje dhe fuqizimin e të rinjve.

Mbështetja për krijimin e kësaj zyre i jep mundësi të rinjve shqiptarë që të orientohen, aftësohen dhe punësohen në vendin e tyre.

Përfaqësues të kësaj zyre shprehen për gazetën “Agrobiznesi”, se së bashku me aktorë

zonat rurale të vendit dhe për këtë, ata duhet të kenë qasje në mjete dhe mundësi. Ndaj dhe projekti RisiAlbania ka si qëllim të mbështesë të rinjtë e zonave rurale të vendit, me qëllim që ata ta gjejnë veten në vendin e tyre.

Ndaj dhe Zyra e Këshillimit të Karrierës ka si qëllim

se si ata mund të ngrënë biznese të tyre në zonat rurale të vendit, të cilat, po shndërrohen në modele edhe për të rinjtë e tjerë (agroturizme apo biznesi artizan).

Ndërsa interesi i të rinjve për të kontaktuar në Zyrën e Këshillimit të Karrierës pranë Bashkisë Tiranë, po rritet dita ditës.

STRATEGJIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE 2023-2030

PUNËSIMI DHE AFTËSITË NË FUSHËN E EKONOMISË SË USHQIMIT, BUJQËSIA SEKTORI QË ANGAZHON NË PUNË PJESËN MË TË MADHE TË SHQIPTARËVE, ME 33.8% TË TË PUNËSUARVE

- **Ekonomia e ushqimit dhe bujqësia është sektori që angazhon në punë pjesën më të madhe të shqiptarëve, me rreth 33.8 për qind të të punësuarve gjatë vitit 2021 (INSTAT).**

- **Sektori i bujqësisë dhe aktivitetet në zonat rurale përbëjnë kategorinë kryesore, ku midis të tjerave problemi i kooperimit dhe informalitetit është ende i pranishëm.**

- **1 në çdo 5 persona të punësuar në Shqipëri, punon pa pagesë në biznesin e familjes.**

- **Grupimet mbi dhe nën moshën për punë në Ekonominë e Ushqimit kërkojnë aktualisht përmirësim të akteve ligjore dhe nënligjore.**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Delina Ibrahimaj prezantoi në Këshillin Kombëtar të Punës, Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030. Ajo tha: "Po ngrihen disa komitete sektoriale, për diskutimin e problematikave në sektorë të ndryshëm. Pas turizmit dhe IT-së, jemi në përgatitje të një komiteti të tretë për fushën e bujqësisë".

Ekonomia e ushqimit në Shqipëri është konsideruar në të gjitha strategjitë e zhvillimit edhe në atë të Punësimit dhe Aftësive si një fushë prioritare. Sektorët kryesorë të kësaj fushe si: Bujqësia, Blegtoaria, Peshkimi dhe Akuakultura, Industria e bimëve mjekësore, aromatike, eterovajore dhe Agropjlltaria, Agrobiznesi, Agropërpunimi, Agroturizmi, Bletaria dhe Mjedisi në zonat rurale, Tregjet Agro Blegto-rale, Subjektet e ushqimit social, gjithashtu dhe Subjektet e financës dhe mikrofinancës, janë dhe do të mbeten edhe në të ardhmen sektorët kryesorë të punësimit. Ekonomia e ushqimit dhe bujqësia është sektori që angazhon në punë pjesën më të madhe të shqiptarëve, me rreth 33.8 për qind të të pu-

nësuarve gjatë vitit 2021 (INSTAT).

Fusha e Ekonomisë së ushqimit përveçse është konsideru-

teve klimatike etj.

Popullsia e Shqipërisë ka përjetuar tkurrje për shkak të emigrimit masiv dhe plakje të

në vitin 2030 popullsia totale e Shqipërisë do të pakësohet edhe me rreth 86 mijë vetë, në vijim të rënies prej mbi 104 mijë vetë gjatë dekadës së fundit 2012-2021.

Skemat mbështetëse nxitën formalizimin, zgjerohet punësimi në sektorin rural

Bujqësia renditet ndër sek-

torët kontribues më të mëdhenj në ekonominë e vendit dhe një burim i rëndësishëm punësimi. Bujqësia ka kryesuar ndër vite si sektor me punësim të lartë, por vitet e fundit sektori ka rritur në mënyrë të qëndrueshme kontributin në PBB. Ndërkohë, diversifikimi i sektorit edhe me investime në zhvillimin rural dhe agroturizëm ka shtuar më tej peshën në punësim. Të dhënat flasin për rritje të forcës së angazhuar në punë në sektorin rural duke dominuar me numrin më të lartë të të punësuarve, në shkallë vendi.

Referuar statistikave të

tremujorin e tretë 2022, punësimi u rrit me 3,9% në sektorin e bujqësisë.

Ndikim në punësim në sektorin rural, që përfshin edhe peshkimin kanë dhënë jo vetëm investimet në mbështetje të sipërmarrjeve, por edhe politikat e formalizimit përmes aplikimeve për fonde.

Kështu, politikat e ndërrmarra nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kanë nxitur formalizimin e fermerëve për të përfituar nga skemat mbështetëse.

Përmes skemave kombëtare, IPARD-it, etj., buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është rritur nga viti në vit, në mbështetje të fermerëve që nxisin prodhimin, punësimin dhe sigurojnë më shumë të ardhura ndërkohë që kanë shtuar sipërmarrjet e reja me trend agroturizmin.

Tashmë është fakt që ekonomitë rurale krahas modelit të vetëpunësimit familjar po orientohen në zgjerimin e punësimit në mbi 10 persona, në varësi edhe të zhvillimit të aktivitetit të tyre, duke kontribuar në rritjen e punësimit.



ar si një fushë prioritare duhet ritheksuar që në këtë periudhë krize është edhe jetike për Shqipërinë. Arsyja kryesore është përfaqimi i trendit të globalizimit dhe hapjes së ekonomisë së Shqipërisë në rajonin e Ballkanit, në Europë e më gjerë. Gjithashtu dhe pasojat e krizës së fundit e shkaktuar nga tërmeti vitit 2019, pandemia Covid 19, lufta e Rusisë kundër Ukrainës, kriza e energjisë, rritja galopante e inflacionit, çmimeve dhe kostove të prodhimit, përkeqësimi i kush-

konsiderueshme gjatë viteve të fundit për shkak të uljes së lindjeve dhe emigrimit të rinjve. Sipas të dhënave demografike të publikuara nga INSTAT, popullsia e Shqipërisë vazhdon në rënie nga viti në vit, për çdo vit gjatë dy dekadave të fundit, përjashtuar vitin 2017, ndërkohë moshë mesatare e popullsisë është rritur nga moshë 33.2 vite në vitin 2012, në moshën 38.2 vite në vitin 2022. Projektionet e popullsisë, sipas skenarit të mesëm të ndërtuar nga INSTAT-i, tregojnë se deri



torët kontribues më të mëdhenj në ekonominë e vendit dhe një burim i rëndësishëm punësimi.

Bujqësia ka kryesuar ndër vite si sektor me punësim të

publikuara së fundi nga INSTAT, në terma vjetorë punësimi u rrit me 6,5% në sektorin e bujqësisë.

Ndërkohë, krahasuar me tremujorin e mëparshëm, në

Konferencë: "Rrugëtimi i eksporteve shqiptare të fruta perimeve drejt tregjeve



Stefan Joss, Drejtor i Projektit RisiAlbania

ndërkombëtare" mblodhi bashkë aktorë ndërkombëtarë dhe kombëtar të fushës së bujqësisë dhe agrobiznesit për të

Stefan Joss: Prioritet edukimi profesional, kërkimi shkencor dhe punësimi në sektorë të ndryshëm si në bujqësi, teknologji apo turizëm

ndarë praktikat dhe përvojat më të mira të fushës.

Fokusi i konferencës ishin standardet e certifikimit në sektorin e fruta perimeve si dhe një panoramë e situatës aktuale në Shqipëri, përfshirë këtu zhvillimet, sfidat dhe mundësitë.

Stefan Joss, Drejtor i Projektit RisiAlbania duke marrë fjalën në këtë Konferencë shprehu kënaqësi që ishte në këtë takim ku diskutohet për tema të rëndësishme dhe për standardet e certifikimit në Shqipëri.

"Si fillim dua të nis të flas

mbi historikun në vendin tim, ku edhe aty në fillim emigrimi ka qënë i lartë pasi standardet e jetesës kanë qënë të ulëta dhe ishin në kërkim të dickaje më të mire", tha ai, teksa vuri në dukje se, e njëjta histori po përsëritet edhe këtu.

"Ajo që duam të bëjmë ne si RisiAlbania është të ndikojmë në punësimin e të rinjve, edukimin e tyre dhe zgjedhjet që ata do bëjnë", deklaroi Joss.

Ai tha se "Duhet të krijojmë mundësi për burrat dhe gratë në zonat rurale, përmes krijimit të vendeve të punës përg-

jatë gjithë zinxhirit të vlerës. Eksportuesit luajnë një rol të rëndësishëm dhe duhet të bashkëpunojnë me grumbulluesit".

“

Stefan Joss:

Ajo që duam të bëjmë ne si RisiAlbania është të ndikojmë në punësimin e të rinjve, edukimin e tyre dhe zgjedhjet që ata do bëjnë.

Stefan Joss theksoi se, Shqipëria është një vend i vogël dhe burimet i ka të kufizuara, ndaj duhet të dini si t'i shfrytëzoni ato për të pasur produkte cilësore.

"I duhet dhënë hapësirë edukimit profesional, kërkimit shkencor, krijimit të shoqatave me fuqi lobuese dhe punësimin në sektorë të ndryshëm si në bujqësi, teknologjinë e informacionit, apo turizëm", deklaroi ai.

Konferenca trajtoi arritjet në lidhje me zbatimin e standardeve të certifikimit të fruta perimeve si kërkesa të

detyrueshme për rritjen e eksporteve në tregjet e BE dhe më gjerë.

Promovimin e vlerave dhe dobishmërisë të zbatimit të standardeve si për tregun vendas, ashtu edhe për tregun e huaj. Forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm vendas, për një progress të qëndrueshëm.

Sot aktorë të tregut u shprehën krenarë që produktet shqiptare po aksesojnë tregjet ndërkombëtare në një numër të lartë vendesh dhe me sasi në rritje.

Kjo konferencë u organizua nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Grupi Kombëtar Teknik i Punës GlobalG.A.P me mbështetjen e RisiAlbania!

AKTUALITET

Konferenca e FAO-s, Krifca: Përpjekje të përbashkëta për sigurinë ushqimore

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Frida Krifca, kryesoi Konferencën e 171-të të Këshillit të Organizatës Botërore të Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO), që po zhvillon punimet në Romë, Itali.

Në hyrje të fjalës së saj, ministria u shpreh për rëndësinë e këtij takimi, ku po diskutohet për politikat e ardhshme bujqësore për t'i dhënë zgjidhje sfidave të reja si siguria ushqimore, si pasojë e luftës në Ukrainë, përmbytjet e shtuara të lidhura me ndryshimet e dukshme klimatike, si dhe domosdoshmëria për politika të përbashkëta në shërbim të rritjes së cilësisë së prodhimit.

“Nder dhe privilegj të mbarja sot fjalën në këtë aktivitet të rëndësishëm ndërkombëtar që mbledhi së bashku aktorë të rëndësishëm të cilët kanë kontribuar në përpjekjen e përbashkët për sigurinë ushqimore

në 2022”, tha ministria Krifca. Sipas saj, muajt e fundit, kanë qenë një shembull i qartë i nevojës për një bashkëpunim gjithëpërfshirës dhe inventar, teksa vuri në dukje, roli i



Organizatës Botërore të Ushqimit dhe Bujqësisë si agjencia kryesore që lufton urinë dhe rrit sigurinë ushqimore në botë, dhe si bashkëbisedues për

sistemet e qëndrueshme të ushqimit, është shumë i mirëpritur në këto kohë sfiduese.

“Shqipëria vlerëson gjetjet dhe rekomandimet e Këshillit të Bujqësisë, veçanërisht

ato që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemeve ushqimore dhe rëndësinë e një dialogu të hapur në dobi të qytetarëve”, deklaroi ministria Krifca.

Bashkëpunim zhvillimor me Gjermaninë, nënshkruhet protokoli i negociatave të reja

Bisedimeve Qeveritare mbi Politikat për Zhvillim 2022, të cilat u zhvilluan nën drejtimin e Ministres së Financave dhe Ekonomisë Delina Ibrahimaj, Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Pro-

Ekonomik dhe Zhvillim Heike Backofen-Warnecke.

Bisedimet e hapura dhe konstruktive rezultuan në një angazhim financiar të Qeverisë Federale në vlerën e 74.3 milionë eurove për dy vitet e ardh-

në bashkëpunim transatlantike dhe evropiane. Qeveria Federale Gjermane do të vijojë të mbështesë Shqipërinë në rrugën e saj të integrimit evropian dhe në proceset e saj transformuese. Delegacioni gjerman përshëndet fillimin e negociatave të anëtarësimit të BE-së me Shqipërinë dhe nisjen e procesit screening.

Gjermania mbetet donatori bilateral më i rëndësishëm i Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim. Ajo do të vazhdojë mbështetjen e saj teknike dhe financiare për reformat në Shqipëri – veçanërisht në sektorët e klimës, energjisë, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, arsimit profesional dhe punësimit. Në fushat e menaxhimit të mbetjeve, furnizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve, bujqësisë dhe energjisë, Gjermania promovon dialogun e politikave sektoriale dhe koordinimin e bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet partnerëve të përfaqësuar në Shqipëri.

shme (2023-2024) në fushën e bashkëpunimit bilateral financiar dhe teknik.

Delegacioni gjerman nënvizoi rëndësinë e Shqipërisë si një partner i besueshëm

Objekti i ri në Durrës, fuqizim i kapaciteteve të MBZHR-së për sigurinë ushqimore

Në portin e Durrësit po ndërtohet objekti i ri për kontrollin kufitar të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, për sigurinë ushqimore.

Drejtoresha e Përgjithme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU) Jeta Deda inspektoi nga afër ecurinë e punimeve, teksa bëri të ditur se, investimi po realizohet në kuadër të projektit SAFIAL të CIHEAM Bari (financuar nga



(Vijon në faqen 5)

Industria e përpunimit të qumështit me teknologji të përparuar

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca

qumështit është tejet e rëndësishme për ne për vetë rolin

e produkteve cilësore, ushqyese për konsumatorët tanë”, u shpreh Krifca në një postim në rrjetet sociale.

Krifca theksoi se, në takim i fol për sfidat e përbashkëta në forcimin e zinxhirit prodhues nga ferma tek konsumatori.

“Punojmë që të perfeksionojmë sistemin e gjurmueshmërisë, të sigurojmë akses më të madh në fonde mbështetëse dhe rritje të kontrolleve nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit”, tha Krifca.

“Më vjen mirë që e kemi mbështetur industrinë përpunuese të fuqizohet me teknologji të përparuar dhe që kemi gjetur bashkëpunimin që të ecim së bashku për më të mirën e qytetarëve tanë”, shtoi Krifca.



zhvilloi një takim me përfaqësues të Shoqatës së Përpunimit të Qumështit.

“Industria e përpunimit të

që ka në grumbullimin, organizimin e prodhimit e fermave të qumështit dhe forcimin e blegtorisë, por dhe në ofrimin

Mbështetje nga AZHBR-ja, pikat e grumbullimit sipas standardeve europiane

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka në fokus të veçantë mbështetjen e investimeve të reja në infrastrukturën magazinuese dhe përpunuese të produkteve bujqësore sipas standardeve më të mira, si faktor

të rëndësishëm në zgjerimin e eksporteve të produkteve bujqësore, duke iu përgjigjur më së miri kërkesave për cilësi dhe siguri të tregut të jashtëm.

Pikat e grumbullimit ndihmojnë fermerët e vegjël në

AZHBR përmes programit IPARD II ka mbështetur rikonstruksionin e ambienteve për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore, blegtoriale, bimëve mjekësore etj., duke realizuar zgjerimin e këtyre pikave.

Investimet në këtë drejtim janë shtrirë në zona të ndryshme të vendit dhe janë kryer për: kushtet më të mira të mirëmbajtjes, dhoma frigoriferike, magazina, linja përpunimi dhe paketimi.

AZHBR bën të ditur se, përmes këtij financimi janë arritur standardet e duhura dhe prezenca e produkteve “Made in Albania”, në tregun evropian është rritur.

Në sajë të programit IPARD II, për pikat e grumbullimit janë 27 përfutues dhe vlera e mbështetjes e dhënë deri tani arrin në 5.6 milionë euro.



kryesor në rritjen e eksporteve. Rritja e numrit të pikave të grumbullimit ka një ndikim

shitjen e produkteve të tyre, apo edhe në ruajtjen e tyre sipas standardeve të kërkuara.

Skema Kombëtare, AZHBR: 41 941 fermerë të disbursuar

Ka arritur në 41.941 numri i fermerëve përfutues nga Skema Kombëtare e Mbështetjes për Bujqësinë 2022, ndërsa vlera e dhënë në 4.02 miliardë lekë.

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) njofton se po vijon punën intensivisht për disbursimin e fondeve subvencion për fermerët e kualifikuar përfutues.

Përmes kësaj skeme dhe mbështetjes së sektorëve të ndryshëm synohet ulja e kostove për fermerët, me qëllim rritjen e prodhimit dhe zhvillimin e ekonomisë rurale.

AZHBR ka mbështetur sektorët e mbarështrimit të bletarisë, tufën bazë, fara/fidanë, ndërtimi i serrave, fermat

organike, kultivimi i bimëve mjekësore, automatizimi dhe

zuara në bujqësi, rinovimi i infrastrukturës së anijeve



digjitalizimi i fermës, si dhe mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekani-

të peshkimit dhe ngritja e tregjeve të produkteve bujqësore.

Krifca: Shqipëria, aktor i besueshëm ndër-kombëtar edhe në takimet për bujqësinë dhe ushqimin

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca në përmbledhjen e aktiviteteve javore të institucionit që drejton e vuri theksin në disa ngjarje të rëndësishme.

Krifca u ndal së pari tek samiti i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor, mbajtur në Tiranë i cili, si theksoi ministria, ishte kryefjala e një jave mbresëlënëse politike për Shqipërinë.

“Kryeqyteti u bë qendra pulsuese e Evropës dhe Ballkanit – aty ku jetësohet vizioni i kontinentit tonë dhe aspiratat e popujve të Ballkanit Perëndimor. Shqipëria dëshmoi në fakt me thjeshtësinë e saj vlerat më të larta të mikpritjes, dinjitetin e një vendi dashamirës, që është në zemër të Evropës, ka në zemër Evropën dhe bën çdo ditë përpjekje për t’u integruar politikisht dhe ekonomikisht në këtë familje të madhe”, u shpreh Krifca.

Ajo vijoi duke theksuar se “qëndrueshmërinë e Shqipërisë si një aktor i besueshëm ndër-kombëtar, i cili di të jetë një zë i fuqishëm në takimet shumëpalëshe, ku diskutohen edhe problemet e zhvillimit të bujqësisë apo ushqimit, patëm mundësinë, ta tregojmë gjatë kësaj jave në Romë, në konferencën e Këshillit të Organizatës Botërore të Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO)”.

Krifca vuri në dukje se në fjalë e mbajtur në këtë konferencë, prezantoi problematikat me të cilat përballen bujqësia shqiptare duke kërkuar një mbështetje më të plotë të Organizatës Botërore të Ushqimit dhe Bujqësisë, si agjencia kryesore e Kombeve të Bashkuara, në betejën që është zhvilluar në fakt këtë vit dhe vijon për sigurinë ushqimore në botë.

“Aty pata mundësinë të takohem edhe me drejtorin e Përgjithshëm të FAO-s, në një takim zyrtar, ku folëm për të jetësuar një kalendar

më intensiv të projekteve në Shqipëri për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë, për rritjen e prodhimeve shqiptare, për certifikimit e tyre, për prezencën e shtuar në tregjet ndërkombëtare, si edhe administrimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore si një prej objektivave tanë të panegociueshëm”, theksoi Krifca.

“Vizita në Romë kishte dhe për qëllim takimin me ministrin Italian të Bujqësisë dhe Sovranitetit Ushqimor me të cilin dakorduam një agjendë punësh për të fuqizuar me tej volumin tregtar mes vendeve tona dhe kërkoja gjithashtu mbështetjen e tij për të krijuar më shumë hapësira për eksportet bujqësore në Itali, ky vend që është mik i patjetërsueshëm i bujqësisë shqiptare dhe një nga donatorët tanë kryesorë”, theksoi ajo.

Krifca u ndal edhe te paneli i zhvilluar gjatë kësaj jave, në Ditën Botërore të Tokës apo të dheut, së bashku me Akademinë e Shkencave dhe Universitetin Bujqësor të Tiranës.

“Diskutoam mes njohësve më të mirë të tokës, me shqiptarë që punojnë në institutet më në zë në botë, për një shfrytëzim më të mirë dhe në mënyrë të qëndrueshme të tokës bujqësore në Shqipëri, ku kërkuesit shqiptarë paraqitën kërkime për rritjen e efektivitetit agronomik dhe ekonomik të saj, për ta mbrojtur atë nga efektet negative si kripëzimi, erozioni etj., duke krijuar kështu një debat zhvillimor midis nevojave që ka sektori sot dhe përgjigjeve që vijnë nga kërkimi”, tha ajo.

“Po ashtu këtë javë së bashku me ambasadorin e Bashkimit Evropian përmbullem një projekt shumë të suksesshëm në administrimin e qëndrueshëm të peshkimit – Fishing Blue, i cili ka rritur formalizimin e sektorit”, theksoi Krifca.

“I ofruam me këtë projekt

peshkatarëve rreth 1,5 milion euro grante për modernizimin e flotës së peshkimit, dhe injektuam njëkohësisht në sektor rreth 3 milion euro investime për aparatura, që rrisin sigurinë në bord, eficiencën energjitime dhe sigurinë ushqimore të produkteve peshkore nëpërmjet kapaciteteve të reja frigoriferike në anije apo dhe qëndrueshmërinë në zënie. Pothuajse të gjitha anijet e flotës së peshkimit kanë përfituar nga këto grante për rinovimin e flotës dhe për përmirësimin e punës së tyre në det. Përmes këtij projekti ne kemi përfituar edhe dy anije patrulluese moderne të pajisura me të gjitha aparaturat në bordin e tyre për një navigim të sigurt dhe për të garantuar kryerjen e detyrave dhe të misionit në det për inspektoriatin tonë të peshkimit duke vënë në efektivitet një kontroll më të mirë të vijës bregdetare. Ky projekt është pjesë përpjekjeve tona për të jetësuar vizionin tonë për 200 milion euro eksporte në vitin 2030”, theksoi ministria.

Krifca u shpreh se e mbyll paraqitjen e punëve të javës me sytë nga e ardhmja, me më të rinjtë të cilët kishin edhe ditën e tyre këtë javë, të cilët po i bashkohen çdo ditë bujqësisë sonë.

“Në Ditën e Rinisë takova rreth 36 veterinerë nga 57 syresh të cilët i janë bashkuar ekipit tonë pranë Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë si veterinerë kontrolli dhe veterinerë shërbimi, në fakt pjesa më e madhe, menjëherë pasi kanë lënë auditorët universitarë, dhe që janë forca shtytëse e institucioneve tona sot. Pashë entuziazmin në sytë e tyre, dëshirën për profesionin, që kishin respekt për bluzën e bardhë që kishin veshur”, theksoi ministria.

“Ishte një javë kjo e mbushur me emocione dhe punë të mira të bujqësisë”, përfundoi Krifca.

Indeksi i Amcham: Gjetja e fuqisë punëtore të kualifikuar, shqetësimi kryesor i bizneseve

Për herë të parë që nga viti 2012, kur Dhoma Amerikane filloi publikimin e indeksit të besimit të bizneseve, në indeksin e fundit shqetësimi kryesor i sipërmarrjeve është gjetja e personalit vendas të kualifikuar të fuqisë punëtore.

Ky tregues mori vlerësimin më të ulët, në 24.47 pikë, nga 100 pikë që është vlerësimi maksimal, duke nxjerrë në pah se mungesa e fuqisë punëtore po kthehet realisht në një pengesë për ecurinë e bizneseve.

Po ndodh një brain drain i vërtetë në Shqipëri këto vite, tha Enio Jace, presidenti i Dhomës Amerikane.

“Duhet të ndërtojmë sëbashku për një motivim të vërtetë, të kthejmë motivin për njerëzit për të ndërtuar një perspektivë ekonomike në Shqipëri dhe kjo është detyra e të gjithëve. Tendenca e largimit që ka filluar në 2020 2021 do të vazhdojë dhe më tej. E rëndësishme është të gjejmë zgjidhje për të frenuar këto tendenca. Shqipëria ka shansin e integritit evropian dhe këtë duhet ta kthejmë në potencial. Është shumë e rëndësishme të bëhen reforma. Dhoma amerikane e ka hartuar tashmë axhendën e investimeve. Duhet të kombinohen me politika shtetërore. Që të bëhet tregu i punës tërheqës duhet të luftohet pastrimi i parave, informaliteti”.

Indeksi i Besimit të bizneseve, një publikim i përvitshëm i Dhomës Amerikane u publikua gjatë konferencës “Forcat e punës, sfidat e të ardhmes

në Shqipëri”, i organizuar nga Dhoma Amerikane dhe Revista Monitor.

Indeksit të Biznesit, i njohur

rim në konsideratë janë nën 50 dhe duhet të shohim sesi akoma nuk kemi një “jumb” një kërcim, një ndryshim të konsiderueshëm



për perceptimin e klimës së Biznesit (2021-2022) në tërësi shënoi përmirësim, në 41.4 pikë, nga 37.66 pikë vitin e mëparshëm. Përmirësimi është i lidhur me situatën më të mirë ekonomike pas vështirësive që kaloi vendi gjatë pandemisë.

“Ka një përmirësim të indeksit të besimit në krahasim me vitin 2020, është një përmirësim me 3.77 pikë. Këtë përmirësim unë do ta interpretoj, edhe pse vijmë pas pandemisë. Gjatë pandemisë patëm një rënie, ndërsa tani kjo periudhë shkon me rritje ekonomike. Po të shohim indeksin ka një lloj qëndrueshmërie në pikën 40, pak më lart, pak më poshtë. Ajo që është e vërtetë është që nuk shkojmë mbi 50. Pavarësisht se kemi rritje, por përsëri klima e biznesit dhe gjithë këto elemente që ne mar-

e cila ka lidhje me përmirësimin e ambientit të biznesit”, deklaroi Neritan Mullaj, drejtor ekzekutiv i Dhomës Amerikane.

Krahas mungesës së fuqisë punëtore, problematikat më të mëdha të biznesit lidhen me monopolin dhe konkurrencën e pandershme, nivelin e lartë të informalitetit të ekonomisë, burokracitë e qeverisë dhe korrupsionit.

Niveli i lartë i taksave të aplikuar, që ka qenë shqetësimi kryesor i bizneseve gjatë periudhës 2015-2017 ka kaluar në problemin e gjashtë në indeksin e fundit.

Në kahun e kundërt, ndër shqetësimet më të ulëta në biznesin në indeksin e fundit renditet sigurimi i energjisë, marrëdhëniet me doganat dhe marrëdhëniet me tatimet.

MBZHR nxit të rinjtë për sipërmarrje në bujqësi: Aplikoni në skemat mbështetëse

“Të rinjtë në sipërmarrje, ka qenë dhe mbetet një prioritet i politikave subvencionuese, përmes të cilave synohen nisat dhe përfshirja e tyre në sektorin bujqësor”.

Kështu u shpreh ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, teksa theksoi se, “çdo i ri nën 35 vjeç që dëshiron të nisë sipërmarrje në bujqësi, blegtori, peshkim e agroturizëm, apo të zgjerojë atë

ekzistuese, mund të aplikojë për të përfituar mbështetje nga skemat financiare e qeverisë”.

Programet subvencionuese parashikojnë masa ku ata kanë prioritet dhe projektet e tyre përqindje më të lartë mbështetjeje në vlerësim.

Gjithashtu tha Krifca “përmes programit IPARD II janë nënshkruar 174 kontrata ku sipërmarrësit janë të rinj të cilët kanë arritur të ndërtojnë

aktivitete të suksesshme në bujqësi”.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bashkë me projektet e donatorëve kanë intensifikuar ciklin e trajnimeve me të rinjtë, për informimin mbi mundësitë që jep sektori bujqësor.

Gjithashtu po i ndihmojnë ata në zgjedhjet dhe orientimin e të tyre pasi janë të rinjtë që ndërtojnë të ardhmen.

Objekti i ri në Durrës, fuqizim i kapaciteteve të MBZHR-së për sigurinë ushqimore

(Vijon nga faqja 4)

Ministria Italiane e Punëve të Jashtme) për fuqizimin e kapaciteteve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për menaxhimin e sigurisë ushqimore.

Projekti SAFIAL drejtohet nga koordinues Francesco Ceglie dhe bën pjesë në një sërë projekte dypalëshe dhe

shumëpalëshe të CIHEAM Bari në Shqipëri në mbështetje të bujqësisë.

Qendra e re, mundëson rritjen e kapaciteteve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për të kryer inspekte eficientë në produktet ushqimore që hyjnë në portin e Durrësit.

“Së shpejti do të ketë ambiente të reja, të posaçme për kontrollin zyrtar të produk-

teve ushqimore në kushtet e përshtatshme të freskisë ose ngrirjes”, tha Deda.

Drejtoresha e AKU-së, u shpreh se, pas ndërtimit të kësaj strukture, do të ketë riorganizim në hapsirën e punës si për inspektorët e pikës së inspektimit kufitar të AKU-së, ashtu edhe për ata fitosanitarë e veterinarë të Kosovës, sipas marrëveshjeve në fuqi.



INFORMACIONE

630 përfitues me 104.2 milionë lekë nga skema e mbështetjes për grurin

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca bëri të ditur se vijon puna për disbursimin e mbështetjes për kultivimin e grurit nga Skema Kombëtare e Mbështetjes.

“Pëmes Skemës së Mbështetjes për kultivimin e grurit, deri tani janë disbursuar 104.2 milionë lekë për 630 fermerë përfitues, që kanë

mbjellë 3491 ha sipërfaqe me grurë”, tha Krifca.

Ministrja informoi se ekipet e bujqësisë vijnë verifikimet në ferma.

“Fermerët që kanë plotësuar kriteret, do të paguhën brenda vitit buxhetor nga kjo skemë e cila i mbështet ata në uljen e kostove të prodhimit, rrit sipërfaqen e mbjellë të grurit në

vend dhe rrit formalizimin”, tha Krifca.

Ministrja solli në vëmendje se, fermerët duhet të respektojnë afatin 16 dhjetor 2022 për dorëzimin e dokumentacionit të pronësisë apo përdorimit sipas kriterëve të shprehura në udhëzime, si edhe faturat e fiskalizuar për blerjen e materialit mbjellës dhe plehun kimik.

Anijet e peshkimit nga 1 korriku 2024 raportojnë online sasi të mbi 50 kg

Anijet e peshkimit nga data 1 korrik 2024 do të raportojnë elektronikisht speciet dhe sasinë e produkteve të peshkut, kur është mbi 50 kg.

Detyrimin për transmetimin e të dhënave nëpërmjet sistemit ERS (Sistemi i Raportimit Elektronik, është komunikimi elektronik i

rabartë ose më të madhe se 12 metra.

Vendimi “Për mënyrën e ngritjes dhe funksionimit të sistemit elektronik të regjistrimit dhe raportimit të aktivitetit të peshkimit dhe përcaktimit të kohës për vënien në funksion të tij” është botuar në Fletoren Zyrtare.

bimit të peshkimit në sallën operacionale informojnë menjëherë kapitenin ose pronarin e anijes, ose përfaqësuesin e tyre.

Nëse për një anije të caktuar kjo situatë ndodh më shumë se 3 herë brenda një viti, institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës siguron që të kryhet një kontroll në sistemin e tij elektronik të transmetimit. Shpenzimet e bëra për blerjen dhe instalimin në bordin e anijeve të peshkimit të pajisjeve ERS mbulohen nga buxheti i miratuar i ministrisë përgjegjëse për peshkimin.

Në total sipas të dhënave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë 230 anije të gjatësisë mbi 12 metra të cilat përbëjnë flotën shqiptare të peshkimit. Nga janari i vitit 2021 për këto anije lindi detyrim ligjor të pajisen me blue box për monitorimin e tyre në det në kohë reale.

Aparaturat janë dizajnuar për të mbajtur edhe sistemin ERS për deklarimin elektronik të të dhënave të peshkimit.



të dhënave të aktivitetit të peshkimit nëpërmjet sistemit hardware dhe software) do ta ketë kapitenin, pronarin ose çdo përfaqësues tjetër i anijes së peshkimit me gjatësi të ba-

Nëse institucionet përgjegjëse për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës nuk kanë marrë të dhënat e transmetuara, siç përcaktohet në vendim, oficerët e shër-

Sipërmarrësja e re me mbështetjen e IPARD ngriti pikën e grumbullimit në Kavajë

Pika e grumbullimit të fruta-perimeve në Gosë të Kavajës është një tjetër investim i mbështetur nga programi IPARD, falë të cilit ka modernizuar kushtet për t'u prezantuar edhe më denjësisht në tregun ndërkombëtar.

Në pikën e grumbullimit “Albania Piemonte”, Eva Zyllyftari, 30 vjeç, e cila sot drejton këtë pikë, tregon detaje nga ky investim.

Ajo thekson se kjo pikë është krijuar në mars të vitit 2014 dhe është e specializuar në grumbullimin, përpunimin dhe ruajtjen në dhoma frigoriferike të frutave dhe perimeve.

“Falë mbështetjes së programit IPARD u ndërtuan magazina të kushteve dhe përmasa të mëdha për t'u prezantuar edhe më denjësisht në tregun ndërkombëtar. Duke

lidhur kontrata me fermerët e vegjël ata ndjekin tërësisht cik-



lin e prodhimit dhe kanë gjurmueshmëri të plotë të produktit për të arritur standardet europiane”, tha Zyllyftari.

Ajo gjithashtu thekson se hapi tjetër i radhës është që për-

punimin që bëjnë klientët e tyre të arrijnë ta realizojnë vetë aty,

duke maksimizuar fitimin nga produktet që grumbullojnë.

Eva shprehet se dashuria për tokën e shtyn për ta zgjeruar akoma më shumë këtë sipërmarrje.

Zgjerohen kapacitetet ankoruese në portin e peshkimit në Durrës

Investimi që po kryhet për shtimin e kapaciteteve ankoruese në Portin e Peshkimit Durrës, pritet t'i japë një hap të ri zhvillimi sektorit, në eksporte dhe punësim.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca ins-

sipas normativave të projektimit për portet, përmbush nevojat e komunitetit të peshkimit.

“Zgjerimi i kapaciteteve ankoruese të anijeve të peshkimit bën që rreth 35 anije të tjera të mund të ankorojnë, për shkak të një nevojë që komu-

ku në vijim do të pasurohet edhe me një markatë peshku të vizitueshme për qytetarët”, shtoi Krifca.

Një investim prej afro 175 milionë lekë zëvendëson një pjesë të bankinave me gurë në bankina me palankola duke shtuar sipërfaqen e ankorimit të anijeve të peshkimit në bankinë me një gjatësi prej 190 m2, si dhe duke siguruar ankorimin e rreth 35 anijeve shtesë të peshkimit.

“Përmes këtij investimi në përmbushim një kërkesë të kahershme të peshkatarëve të cilët, të shtuar në numër, kanë patur vështirësi të ankorojnë të gjitha anijet në hapësirën në dispozicion”, theksoi Krifca.

Ky investim i rëndësishëm, po kryhet me angazhimin e plotë nga MBZHR dhe Krifca shprehu bindjen se brenda marsit ky investim do të finalizohet, duke i dhënë kështu mundësinë edhe barkave të vogla të ankorohen aty.

“Jam shumë e lumtur për këtë ecuri fantastike të bërë deri më tani dhe shumë shpejt do të shohim një realitet tjetër”, theksoi ministrja Krifca.



pektioi në Durrës këtë investim të rëndësishëm që MBZHR po zbaton për përmirësimin e infrastrukurës në portin e peshkimit duke synuar zgjerimin e kapacitetit ankorues të anijeve të peshkimit.

Krifca u shpreh se shtimi i kapaciteteve ankoruese në Portin e Peshkimit Durrës (bankinë)

niteti i peshkimit ka pasur në Durrës për këtë investim”, tha ministrja Krifca.

“Porti i peshkimit do vijojë të qëndrojë në pozicionin aktual edhe pas investimit strategjik të portit Durrës, duke u bërë i aksesueshëm nga komuniteti i qytetit bregdetar dhe pjesë integrale e jetesës së këtij qyteti,

Shqipëria rrit eksportin e peshkut ton

Sektori i peshkimit në vend, vijon të shënojë risi. Për 8 muaj, kompania e njohur “Rozafa”, solli nga brigjet afro-afrikane në fermat e saj në detin Jon, koloni me peshk ton.

Që në nisje të këtij aktiviteti, bashkëpunimin e patën me Japoninë, ndaj dhe përfaqësuesi diplomatik i këtij shteti, ambasadori Takada Mitsuyuki, ishte në Sarandë për të parë nga afër ecurinë e gjithë procesit.

Kjo kompani, e cila tashmë zhvillon një cikël të mbyllur sa i përket kultivimit, gjuetisë, sistemimit dhe paketimit për eksport, tregun e ka të sigurt.



Kontratat më të mëdha i ka me markatat më serioze të botës, e

në shtetet më të zhvilluara, siç janë Japonia dhe SHBA-të.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese miraton pr/ligjin për “Për vreshtarinë dhe verën”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, miratoi sot

e këtij projektligji ishin zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Dhim-

“ky projektligj ka për qëllim të përcaktojë vendosjen e rregullave për kultivimin e vreshtave që përdoren për prodhimin e verës, regjistrin e vreshtarisë, prodhimin, etiketimin, marketingun, potencialin e prodhimit dhe kontrollin e produkteve të verës në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas tij, qëllim është përshtatja e zhvillimi i këtij sektori me kërkesat dhe standardet e tregut ndërkombëtar, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, duke ruajtur një konkurrencë të drejtë ndërmjet prodhuesve dhe operatorëve të tjerë në sektorin e verës, dhe nxitjen e përmirësimit të cilësisë së produkteve.



projektligjin “Për vreshtarinë dhe verën”.

Të ftuar për shqyrtimin

itër Kote dhe Alban Mësonjësi, drejtor juridik.

Zv.ministri Kote tha se,

AGROTURIZËM

Promovimi i ofertës turistike, gjenerim të ardhurash në zonat rurale

Promovimi i ofertës turistike shqiptare në tregun vendas dhe atë ndërkombëtar është i domosdoshëm, si një mënyrë e shkëlqyer për gjenerimin e të ardhurave në zonat rurale.

sërë nismash për promovimin e turizmit të aventuarës, ku vizitorë, turistë dhe të apasionuar pas natyrës, patën mundësi të eksplorojnë turizmin malor, krahas atij detar dhe liqenor.

turës me produktet turistike të zhvilluara nga SRD përgjatë fazës së parë të projektit.

Të pranishëm ishin operatorë turistikë, udhërrëfyes, përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, donatorë dhe struktura akomoduese në vend.

Produkte të ndryshme turistike në natyrë, në variacionet e tyre bashkëkohore si: ecje malore, çiklizmi në rrugë dhe në mal, kacavjerrje, agroturizmi, eventet dhe festivalet promovuese të traditave, përvojave kulturore dhe kulinare, njihen si opsione për diversifikimin e ekonomive rurale veçanërisht në malësi, në bregdet dhe në afërsi të prekshme natyrore dhe kulturore.

Zhvillimi i tyre i mëtejshëm varet shumë nga transformimi i turizmit drejt një kahu miqësor ndaj natyrës dhe të qëndrueshmërisë.



Me mbështetjen e qeverisë gjermane përmes projektit për zhvillimin e qëndrueshëm rural, (SRD) nisën rrugëtimin një

Pas një rrugëtimi plot sfida të katër viteve të fundit, u zhvillua event i familjarizues i sektorit privat të turizmit të aven-

Kantina në Berat, Krifca: Modeli i agroturizmit që garanton zhvillim

Levend dhe Elsaev Nurellari janë dy vëllezër të cilët në moshë shumë të re kanë nisur të administrojnë kantinën e verës "Nurellari", në Berat.

E krijuar që prej vitit 1996, kantina "Nurellari" tashmë përveç tregut vendas është prezente edhe në tregun Europian.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca, vizitoi kantinën e verës "Nurellari" në Berat, ku puna transformuese e bërë nga sipërmarrja private, gërshetuar me mbështetjen e marrë falë skemave kombëtare dhe programit IPARD, e kanë kthyer këtë zonë, në një pikë tërheqëse turistike.

"Zhvillimi i agroturizmit mbetet një ndër prioritetet e qeverisë, duke parë potencialin akoma të pashfrytëzuar plotësisht që ka vendi ynë",

tha ministrja, teksa e vlerësoi këtë sipërmarrje modelin e suksesshëm agroturistik që garanton zhvillimin e zonave rurale.

Në sajë të mbështetjes së pro-

ruajtjen e produktit.

Edhe pse shumë të rinj, Levendi dhe Elsaevi janë të bindur mbi rëndësinë e vazhimit të kësaj sipërmarrje familjare dhe



gramit IPARD II, ata kanë bërë të mundur zgjerimin e vreshtave dhe kanë pajisjet e duhura për

ftojne të rinjtë që të mos largohen nga toka, por ta respektojnë duke e punuar atë.

Festa e gjelit të detit, promovim produkteve të fermerëve të Cërrikut

Promovimi i produkteve të fermerëve të Cërrikut ishte në fokus të festës së gjelit të detit, një organizim i përvitshëm i bashkisë Elbasan, në prag të festave të fundvitit që synon të nxisë zhvillimin e ekonomisë lokale, pasi në këtë zonë të shumta janë familjet fermere që mbarëshojnë gjelat e detit për t'i shitur në fundvit.

Zv.ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Dhimo Kote i pranishëm në këtë aktivitet, u shpreh se, qarku i Elbasanit spikat në mbarëshkrimin e gjelave të detit. Në këtë qark mbarëshkohen mbi 160 mijë gjela deti, që janë gati për treg këtë vit.

Ndërkohë, krahasuar me vitin e kaluar, këtë vit janë 20

mijë gjela deti më shumë. Kote e vlerësoi këtë fakt, si një interes të shtuar të fermerëve dhe tregut, pasi siç tha ai, "është tregu ai që bën kërkesë ofertën, që është shtuar numri i krerëve, krahas politikave mbështetëse që zbaton qeveria për fermerët".

Festa e gjelit të detit vjen si ndërthurje e elementëve tradi-



cionalë të zonës së Cërrikut, të folklorit, të prodhimeve vendase, trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Festa ka si qëllim kryesor promovimin e prodhimit vendas, traditës, folklorit, trashëgimisë, shndërrimin e tyre në asete promovuese të zonës dhe nxitëse të agroturizmit.

Zona e Cërrikut në qarkun e Elbasanit është një krahinë që shquhet për rritjen e këtij shpendi tradicional, që zbkuron tryezat e darkës së ndërrimit të viteve.

Aktiviteti u konceptua si një panair gjithëpërfshirës me prezantime të produkteve bujqësore, blegtorale, produkte të pemtarisë të zonës, bletarisë dhe të prodhimeve të artizanatit.

Eksportimi i prodhimeve të freskëta i konsoliduar, më shumë investime në përpunim

Kryeministri Edi Rama dhe ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Frida Krifca inspektuan sot ambientet e kompanisë "Riviera" në Kamzë, një sipërmarrje e ngritur nga 4 vëllezër, që kursimet e tyre të emigracionit i investuan në Shqipëri duke ndërtuar këtë pikën grumbullimi spektakolare, ku mbledhin prodhime nga një rrjet fermerësh në të gjithë vendin.

"Me mbështetjen e qeverisë përmes programit IPARD, kjo pikë ka 12 dhoma frigoriferike me një kapacitet prej 7 mijë metër kub, dhe paga mbi 50 mijë lekë për punonjësit e saj", shtoi Rama.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca u shpreh se, "kompania e ka kryer investimin në vitin 2021 dhe e futi në eficiencë vjet, grumbullimin e fruta-perimeve dhe e ka vënë në punë", teksa vuri në dukje se këtu janë të punësuar aktualisht rreth 10 punonjës, grumbullues, përpunues, ekonomistë etj.

Krifca shtoi se "në Kamzë një pikë grumbullimi si kjo nuk ekziston. Është aktualisht një qendër reference praktikisht. Ka grumbulluar mollët nga e gjithë zona e Dibrës dhe zona e Korçës".

"Isha në një vizitë në Itali javën e kaluar, takova ministrin e Bujqësisë atje dhe i kam kërkuar të sjellin një përfaqësi këtu të bizneseve, hipermarketeve italiane, zinxhirëve të tregtisë atje, në mënyrë që ata me sytë e tyre të shohin se çfarë kapacitetesh grumbulluese kemi ne, që janë fantastike, sepse janë të bëra me teknologjinë e fundit dhe kemi lënë me ministrin një axhendë të tillë", tha Krifca.

Ministrja shtoi se, "plani i biznesit është për t'u ndërtuar këtu një përpunim të thelluar

ngrirës të produkteve bujqësore, në mënyrë që atë import që kemi, që na është shtuar, importi i produkteve bujqësore, të përpunuara, pra të ngrira, të kryhet në vendin tonë, se nuk ka arsye që ne të eksportojmë produkte bujqësore të freskëta dhe të importojmë pastaj produkte të ngrira. I kemi të gjitha kapacitetet dhe një biznes si ky patjetër që mund ta



bëjë këtë".

Sa i përket eksporteve, ministrja Krifca u shpreh se, "jemi shumë mirë. Kemi aktualisht shifrat e fundit të janar-nëntor. Jemi në 49 miliardë lekë, kështu që të përkthyer kjo në një kurs me dollarin 1 me 1, siç e kemi parashikuar që në fillim të vitit, ne do ta kapim patjetër objektivin që kemi pasur për 500 milionë dollarë brenda dhjetorit".

Kryeministri Rama theksoi se, "hapat e parë të përpunimit kanë filluar të hidhen. Këtu është faza tjetër tani që duhet të përpunojmë këtu që të mos mbetemi. Kjo pjesa e sistemit të grumbullimit dhe eksporteve të prodhimeve të freskëta është konsoliduar dhe natyrisht do të zhvillohet dhe do të ketë korsinë e vetë. Kurse korsia e re tani që është hapur, por do shumë punë tani

është korsia e përpunimit. Duhet të përpunojmë këtu, të kemi të gjithë salcat, reçelat, kompostot, ingredient të tjerë që rezultojnë nga përpunimi, në mënyrë që pastaj asnjë kokërr fruti apo perime të mos hidhet. Ajo pjesë që nuk është 100% cilësore për eksportin të përpunohet dhe të jetë vlerë e shtuar".

Nga ana e saj ministrja

Krifca deklaroi se, "transformimi që kemi bërë përmes mbështetjes së pikave të grumbullimit ka qenë vlerë e shtuar në rritjen e eksporteve".

"Aktualisht kemi rreth 270 pika grumbullimi në të gjithë vendin. Rreth 165 prej tyre janë të mbështetura financiarisht përmes programeve tona të mbështetjes. Nuk do të kishte qenë e mundur që një investim i tillë të kryhej pa këtë program mbështetjeje. Kështu që ne në parlament të enjten çojmë programin IPARD 3, i cili vjen me një vlerë edhe më të madhe të shtuar të financimit, me masa të tjera. Shkojmë në 146 milionë euro mbështetje për programin IPARD 3 deri në 2027-ën. Kështu që vijojmë punë pikërisht për të kryer përpunimin e thelluar në vend", tha ministrja Krifca.

Projekti i BB për turizmin, avancojnë punimet në zonat turistike të Bënjës dhe Zvërnecit

Banka Botërore ka vlerësuar së fundmi projektin për turizmin duke nënvizuar se ecuria e një pjese të mirë të komponentëve ka qenë pozitive dhe punimet civile kanë filluar në një pjesë të mirë të tyre duke avancuar. Po kështu ka pasur ecuri të mirë edhe pjesa e konsulencës.

Projekti në fjalë ka një total prej 105 milionë dollarësh si financim të ndarë në disa komponentë. Por si paraqitet ecuria e tyre?

"Komponenti 1. Punimet civile të rrugës me kalldrëm të këmbësorëve dhe rrugës së aksesit të mjeteve në Kalanë e Beratit, shëtitores së Sarandës dhe shkallëve të Përmetit.

Ka përfunduar përmirësimi

i integruar urban dhe ndriçimi i rrugëve dhe rruga me kalldrëm e Pazarit të Gjirokastrës dhe Sistemi i Muzeve; punimet civile të përmirësimit të integruar urban në Berat dhe rehabilitimi i Kalasë së Gjirokastrës po zbatohen; konsulencia e projektimit për përmirësimin e integruar urban në Sarandë dhe Gjirokastrë po zbatohet.

Komponenti 2. Kanë filluar punimet për përmirësimin e zonave turistike të Bënjës dhe Zvërnecit dhe të pikave panoramike përgjatë korridorit turistik.

Konsulencia projektimit për zonat turistike të Kalasë së Gjirokastrës si dhe Kalasë së Borshit, Kalasë së Kaninës dhe Shpellës së Spillesë janë duke u zbatuar.

Komponenti 3. Konsulencia për Strategjinë e Kërkimit dhe Zhvillimit të Tregut ka përfunduar. Shërbimet e konsulencës për Partneritetin e Menaxhimit të Destinacionit, Zhvillimin i Tregut, hartimi i Sistemit të Statistikave të Turizmit dhe Paketa e Zhvillimit të Produkteve Turistike janë në zbatim. Konsulencia për paketën 2 të zhvillimit të produkteve turistike është aktualisht në prokurim".

Projekti për Integrimin Urban dhe Zhvillimin e Turizmit nisi në vitin 2017 pas një kredie të dhënë nga Banka Botërore ndërkohë që u rishikua dhe iu shtua një financim i ri në korrik të këtij viti. Ky projekt parashikohet të mbyllet në 31 korrik 2025.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



**MBËSHTETJE FINANCIARE
PËR TË GJITHË FERMERËT**

**KREDI E DEDIKUAR
PËR MBJELLJEN E GRURIT**



INFORMACIONE

Ministrja e bujqësisë: Mbi 5 mijë blegtorë, përfitues nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në bujqësi

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca deklaroi se qeveria ka rritur Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi në Aktin Normativ për këtë vit edhe me 200 milionë lekë shtesë.

Në një videomesazh publikuar në rrjetet sociale, Krifca shprehet se me këtë fond mbështeten edhe 1 mijë blegtorë të tjerë duke e çuar numrin e përfituesve vetëm në blegtori në 5700 blegtorë anembanë vendit, për rreth 800 mijë krerë të imta dhe rreth 50 mijë krerë gjedhë.

Ministrja shprehet se me këtë mbështetje financiare ulen kostot e tyre të prodhimit për tregjet, duke siguruar prodhim vendi për qytetarët tanë për produktet e qumështit apo të mishit.

“Shkojmë në nivelin historik më të lartë të mbështetjes të ofruar ndonjëherë në

mbështetje të drejtpërdrejtë me 5.1 miliardë lekë, pa përfshirë këtu investimet IPARD të kryera gjatë këtij viti dhe që vazhdojnë të kryhen duke prekur drejtpërdrejtë rreth 47 mijë fermerë”, thekson ministrja.

Gjithashtu, Krifca shton se “po ecim me shpejtësi që t’i paguajmë të gjithë fermerët, blegtorët dhe peshkatarët përfitues të masave të mbështetjes brenda dhjetorit”.

Blegtoria në Shqipëri ka hyrë në një fazë ndryshimi drejt konsolidimit të saj, në ferma me numër më të madh krerësh, që i përgjigjen kërkesave të zhvillimit që ka marrë industria përpunuese në vend.

Sipas MBZHR, blegtoria mbulon 97 % të nevojave të tregut vendas për qumështit dhe nënproduktet e tij. Kjo ka ardhur nga fermat e mëdha dhe të mesme që janë konsoliduar tashmë në aktivitetin e tyre, ku është investuar në fakt jo vetëm në rritjen e kapaciteteve të tyre, por edhe të cilësisë dhe standardeve të tyre. Stabilizimet e përpunimit të qumështit sot punësojnë 1 300 punonjës dhe përpunojnë 204 mijë tonë qumësht në vit duke prodhuar 43 mijë tonë qumësht dhe nënprodukte blegtorale.

Në lidhje me shifrat e raportuara së fundmi për ulje të numri të krerëve në fermat



blegtorale, ekspertet shpjegojnë se, “kjo ka të bëjë fillimisht me inventarizimin fizik të krerëve që ka nisur të bëhet në fund të të 2019, por jo duke përdoruar

strukturat veterinarë”.

“Me gritjen e Agjencisë për Mbrojtjen e Bimëve dhe të Veterinarisë, kemi mundur punësimin e 360 veterinerëve

të rinj shtesë dhe do të jetë kjo agjencia përgjegjëse që do të bëjë një azhormim faktik të krerëve, në sistemin elektronik Ruda edhe më tej. Shërbimi Veterinar sot, ka përgjegjësi të bëjë kontrollin edhe në tregjet e kafshëve dhe thertoreve, funksion që më parë e kishin bashkitë. Që nga marrja në përdorim e kontrolleve të 66 tregjeve, ne kemi vënë re rritje të numrit të krerëve me certifikatat përkatëse. Por pavarësisht kësaj blegtoria është një moment ndryshimi të strukturës së fermave blegtorale, ku shënohet një ulje me 7 % e krerëve në ekonomitë e vogla fermere që kanë nga 1 deri 4 krerë lopë. Ndërsa vëmë re rritje me 17 % të numrit të krerëve në ferma që kanë nga 10 deri 50 krerë lopë. Kjo shifër është më e lartë në ferma më të mëdha”, deklaroi ekspertet.

Belshi, qyteti i parë shqiptar pjesë e programit “Green Destinations”

Bashkia e Belshit është angazhuar me “Green Destinations”, një program ndërkombëtar për

ka njoftuar se do të jenë pjesë e një programi ndërkombëtar për menaxhimin e qëndrueshëm

të Këshillit Global të Turizmit të Qëndrueshëm për menaxhimin e qëndrueshëm të turizmit. Në njoftim thuhet se gjatë vitit të ardhshëm, Bashkia Belsh do të fokusohet në kriteret bazë, me një synim afatgjatë për marrjen e çmimit të Destinacionit të Gjellbër dhe Certifikimin.

Në një postim në rrjetet sociale, kryetari i Bashkisë së Belshit, Arif Tafani tha se “Bashkia nënkroi javën e kaluar një marrëveshje me Spoonbill Nest Innovation Center, Përfaqësuesi i Destinacioneve të Gjellbra për Shqipërinë, për të filluar punën drejt përmbushjes së kriterëve të Global Sustainable Tourism Council (GSTC) (Këshillit Global të Turizmit të Qëndrueshëm) për menaxhimin e qëndrueshëm të turizmit”.

Sipas tij, gjatë vitit të ardhshëm Bashkia e Belshit do të fokusohet në kriteret bazë, me një synim afatgjatë për marrjen e çmimit të Destinacionit të Gjellbër dhe Certifikimin.

“Peizazhet natyrore, vendet historike dhe produktet vendase të Bashkisë Belsh e bëjnë atë një vend ideal për turizmin rural dhe të jashtëm. Bashkia

shpreh nevojën për të zhvilluar turizmin me shumë kujdes dhe vizion afatgjatë dhe ka zgjedhur të ndjekë objektivat e turizmit të qëndrueshëm për të garantuar cilësinë dhe shëndetin e komunitetit dhe ekonomisë lokale për brezat që do të vijnë.”, tha kreu i Bashkisë.

Gjatë shekujve IV-VI e.s. Belshi ishte një qytet i fortifikuar me mure guri, por më pas mbeti vetëm një fshat i zakonshëm. Në qendër të historisë qëndron Kalaja e Gradishtës dhe bashkë me të historia për princin ilir të Belshit.

Me lartësinë prej rreth 350 m, mali i Gradishtës dominon gjithë zonën përreth. Ky është një nga destinacionet më tërheqëse të Dumresë dhe preferohet nga të gjithë për shkak të lehtësisë për t'u ngjitur në majë.

85 liqenet karstike të zonës së Dumresë, ku bën pjesë edhe Belshi, i vizitojnë veçanërisht turistët e huaj, por vitet e fundit me transformimin që i është bërë kësaj zone me bukuri të jashtëzakonshme natyrore, fluksi i vizitorëve po shtohet edhe me qytetarë shqiptarë, sidomos nga Tirana dhe Durrësi.

Kultivimi i lajthive, mbështetje për projektin inovativ të Julvin Markut

Masat e mbështetjes në Bujqësi janë tashmë realitet i prekshëm që i vijnë në ndihmë qindra bizneseve të vogla,

sipërmarrjeve në bujqësi duke bashkëpunuar edhe me projektet e donatorëve.

Një histori suksesi është ajo e Julvin Markut, sipërmarrësit dhe themeluesit të fermës së lajthive “Hazeland”.

Ai është gjithashtu një prej pjesëmarrësve që ka përfituar mbështetje përveç trajnimeve dhe këshillimeve të vyera, edhe në një mori përmirësimesh që kanë ndikuar pozitivisht në fermën që menaxhon.

Mbështetja e projektit të tij ka lehtësuar disa procese të punës që më parë bëheshin manualisht, si dhe në prodhimin e energjisë për vaditje që tashmë kryhet me panele fotovoltaike të cilat janë mundësuar nga granti i GIZ, teksa është përfitues i skemës së karburanteve për të tretin vit me radhë.

Në terma afatgjatë Julvini shprehet se brandimi i cili i është bërë produktit të tij dhe përmirësimet teknologjike do të jenë dy elementë mjaft të mirë promovues për të ardhmen e “Hazeland”.



por edhe atyre në zhvillimin e sipër, që operojnë në sektorin rural.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, po zgjeron mundësinë e mbështetjes së



menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në rajon.

I njohur si vendi i liqeneve, kryeqendra e zonës së Dumresë që mban emrin Belsh është kthyer në një nga zonat më të frekuentuara të turistëve vendas dhe të huaj.

Për shkak të bukurive të shumta dhe vlerave që mbart Belshi është bërë tashmë pjesë e “Green destinations”. Bashkia Belsh

të turizmit, për të ndihmuar në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në rajon. Për këtë flet punonjësia e Bashkisë së Belshit Matea Gjoshi.

“Javën e kaluar, Bashkia nënkroi një marrëveshje me Spoonbill Nest Innovation Center, përfaqësuesi i Destinacioneve të Gjellbërta për Shqipërinë, për të filluar punën drejt përmbushjes së kriterëve

Boronica dhe Dëllinja - Bimët medicinale më të preferuarat në tregje

Në vitin e shpërthimit të pandemisë COVID-19 kërkesa për produkte të shëndetshme u rrit në mënyrë dramatike dhe këtë interes e ndjeu sidomos industria e bimëve aromatike e medicinale.

Një studim i mbështetur nga GIZ dhe Ministria e Bujqësisë tregon se dy nga produktet shqiptare më të kërkuara në tregje ishin boronica dhe molla e egër por për tregtarët kjo kërkesë në disa raste u shoqërua me humbje. Një pjesë e mirë kishin lidhur kontrata për boronicën me çmime më të ulëta sesa në fakt e blenë atë në tregun e brendshëm ku prodhimi ishte më i ulët sesa parashikohej. Studimi në fakt analizon të gjithë elementët për bimët medicinale si sektor duke e parë në këndvështrimin e nxitjes që mund t'i jepet sektorit përmes masave të IPARD III.

“Mbledhja dhe kultivimi i



bimëve aromatike dhe medicinale për prodhimin e vajrave esenciale është rritur në mënyrë të konsiderueshme viteve të fundit. Gjethet e dafinës, lule makthit, sherebela, dhe kokrrat e dëllinjës janë kryesoret nga

bimët aromatike dhe medicinale nga të cilat merret vaji esencial” thuhet në studim.

Injenti vlerëson se mes luleve çaji i malit është ai që përfaqëson një nga prodhimet kryesore. Ai kultivohet kryesisht në zonën

jugore dhe juglindore.

“Megjithatë, kultivimi i çajit të malit (Sideritis) nuk ka qenë shumë i suksesshëm. Humbja e cilësisë, jetëgjatësia e shkurtër e bimës së kultivuar në disa zona (p.sh. Devoll) (për shkak të niveleve të larta të lagështisë së tokës), dhe rënia e çmimit ka bërë që fermerët të braktisin kultivimin. Kultivimi qenë më mirë në zonat malore pranë Prepsës dhe Gjirokastrës” raportohet në studim sipas përshtypjeve të marra nga palët e interesit.

“Një trend i vënë re kohët e fundit në zonat e Ersekës, Dibres dhe Kelmendit është kultivimi i agulicës. Intervistat me përfaqësuesit e agjencive shtetërore dhe fermerët tregojnë

se bimë është fitimprurëse krahasuar me disa kultura të tjera më të zakonshme, veçanërisht në zonat me tokë joproduktive.

Ndër frutat e eksportuara vlen të përmendet molla e egër, dëllinja e zakonshme dhe e kuqe, boronica. Kërkesa për dëllinjë në vitin 2020 u rrit ndjeshëm, duke nxitur konkurrencë të ashpër midis kompanive eksportuese shqiptare. Si rezultat, çmimet janë rritur ndjeshëm. Në mënyrë të ngjashme, çmimet e boronicës u rritën në vitin 2020 për shkak të prodhimit të ulët. Disa eksportues shqiptarë humbën para pasi çmimet e kontraktuara me blerësit e huaj ishin më të ulëta se ato të brendshme”

thuhet në studim.

Ky dokument bën edhe një analizë SËOT duke paraqitur kështu pikat e forta e të dobëta si dhe mundësitë e kërcënimit që ka sektori. Sa i takon mbështetjes nga IPARD III nënvizohet se do të ketë një vend të rëndësishëm për financimin në sektor duke dedikuar masa specifike.

Sa i takon profilit të Shqipërisë në sektorin e bimëve medicinale dhe aromatike vlerësohet se 15 për qind e specieve kanë të tilla veti. Sektori ka një traditë 60 vjeçare ndërkohë që të përfshirë direkt apo indirekt duke marrë të ardhura nga ky sektor llogariten 100 mijë persona. Të paktën 20 mijë janë të angazhuar në mbledhje dhe 4 mijë në kultivim. Të paktën 95 për qind e bimëve që mbledhen eksportohen. Vetëm vajra esenciale u eksportuan në 2020 në vlerën 4.6 milionë euro.

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE LUSHNJE

PERKUJDESJET
NDAJ BIMËVE

Proceset biologjike tek bima e grurit ashtu si dhe në bimët e tjera janë të pariktheshme. Kjo do të thotë se një proces ndodh vetem një herë. Po qe se bimës gjatë ndodhjes së këtij procesi biologjik i plotësohen në rregull të gjitha nevojat për ujë ajër, dritë, nxehtësi dhe ushqim, atëherë ajo shpreh aftësinë e saj maksimale prodhuese. Po qe se ndonjëra nga kërkesat e mësipërme asaj i mungon dhe bima vuan, atëherë mungesa do të lerë gjurmë në jetën e saj. Efekti i këtyre gjurmëve edhe kur është i pakapshëm nga syri i nriut, përsëri i jep goditje prodhimit të ardhshëm, i cili ulët.

Nga ky kushtëzim biologjik, vecanrisht për marrjen e rendimenteve të larta në grurë fermerëve u del nevoja, që perkujdesjet ndaj bimëve si: kullimi, plehërimi, luftimi i barërave të këqija etj., të kryhen të plota në kohën e duhur dhe me cilësi të lartë.

KULLIMI

Marrja e rendimenteve të larta në grurë është e kushtëzuar me sigurimin e një regjimi të përshtatshëm uhor në tokë nga mbjellja deri në pjekje. Po qe se ky regjim do të priset nga teprica e ujit në tokë pasojat do të jenë shumë të rënda: rrënjët mbeten në sipërfaqe e nuk zhvillohen në thellësi, priset aktiviteti mikrobiologjik, ulet koeficienti i shfrytëzimit të plehrave, toka ngjishet priset struktura e saj etj. Bimët zhvillohen të dobëta e të zverdhura dhe në rastin e ndonjë thatësire nuk e durojnë dot atë, si pasojë rendimenti ulët. Në kushtet e këtij viti bujqësor me reshje relativisht të shumta është e rekomandueshme për të gjitha

KIJTESE KËSHILLUESE PËR FERMERËT
QË KANË MBJELLË GRURË

zonat ekologjike ku kultivohet gruri, organizimin e disa masave të forta për kullimin e tokave ku është mbjellë kjo bimë, si në fushë në kodër në tokat e pjerrta e kudo, për kushtet e vendit tonë kullimi është vendimtar për marrjen e rendimenteve të larta.

Në kompleksin e masave për kullimin e tokave të grurit më kryesorët janë:

- Zgjedhja e sistemit të punimit të përshtatshëm të tokës që për mbjelljet e vjeshtës duhet mbyllur (skolinazhi me kurriz). Nivelimi shumë i mirë sipërfaqësor i saj

- Drenazhimi i përkohshëm (urit) ose i përhershëm nëntokësorë. Distanca e drenave varet nga përbërja mekanike e tokës 2 deri 4 metra dhe në një thellësi 15-20 cm, më shumë se plugimi i tokës. Hapja e vijave kulluese sipërfaqësore kur toka është e pluguar me sistemin kurriz ato hapen në vendin me teulet aty ku mbullet skolina. Largesia e tyre varet nga perberja mekanike e tokës ku ajo shkon nga 16 metra deri në 32 metra gjerësi, por në vendin tonë ato zakonisht bëhen 23 metra gjerësi. Thellësia e vijave kulluese duhet të jetë në zonat kodrinore malore ato hapen 40-50cm, për zonat fushore ato hapen 60-70cm. Zakonisht vijat kulluese derdhen në kanalim e tretë kullues që kufizon me parcelën ku është mbjellë gruri por ato mund të derdhen edhe në një kryebrazdë të hapur enkas për këtë qëllim.

Spektori i Grurit: QTTB-Lushnje
E-mail: qttblushnje@yahoo.com

Vijat në kushtet e sotme hapen të drejta me traktor, pastrohen nga dherat, por ato mund të hapen edhe para mbjelljes. E rëndësishme për fermerin i cili kultivon bimën e grurit është që sistemin e kullimit në parcelën e tij ta ketë gjithmonë funksional gjatë të gjithë ciklit bimor të bimës së grurit. Fermeri i kujdesshëm gjithmonë pas rënjes së shirave kontrollon parcelën e tij me grurë, që të mos ketë asnjë problem me kullimin sidomos ujërat sipërfaqësore.

PLEHËRIMI PLOTËSUES
(GJATË VEGJETACIONIT)

Gjatë ciklit bimor pas mbirjes bima e grurit kërkon të ushqehet kryesisht me plehra azotike. Ato i jepen bimës në formën e nitrarit të amonit ose të uresë, sulfatit të amonit ose plehut të lëngshëm, por kur është mundësia gjatë vegjetacionit përdoret edhe plehërimi me anë të spërkatjes gjethore.

Kriteret kryesore të plehërimit plotësues azotik të grurit janë si më poshtë:

- Sasia më e madhe e plehut hidhet pak me para se bima të realizojë rritjen intensive të saj.
- Për tokat e lehta me kompleks thithës të dobët e njëjta sasi hidhet në më shumë duar se ato të rënda.
- Në vite me dimër e pranverë të lagësht e njëjta sasi hidhet në më shumë duar dhe me doza më të vogla, se sa kur moti është me

kushte normale

- Në kushtet e lagështisë përdorimi i uresë ka më shumë efektivitet se nitrati

- Në kushtet kur ka thatësi sidomos gjatë vllazërimit rekomandohet plehërim i lëngshëm.

- Doza dhe sasia e plehut plotësues që do të hidhet janë të përcaktuara në bilancin e grurit në bazë të pjellorisë së tokës, rendimentit të planifikuar dhe kërkesave që ka secili kultivar ose lloje gruri. Plehërimi plotësues tek gruri bëhet në 3- 5 duar. Sasia që duhet të hidhet është 30 deri në 50kg/dynym, e shpërndarë kjo sasi sipas fazave të zhvillimit të bimës grurit, p.sh., gjatë fazës së vllazërimit mund të hidhet dora e parë deri në 25% të sasisë së planifikuar, gjatë fazës para ngritjes mund që të hidhet 25-30% dora e dytë, gjatë fazës së ngritjes masive që i bie dora e tretë hidhet 30% e sasisë të planifikuar, gjatë fazës së kallzimit hidhet 20% e sasisë të planifikuar që i bie të jetë dora e katërt, në këtë moment mbaron hedhja e plehërimit plotësues. Shërbime të tjera për kulturën e grurit gjatë vegjetacionit deri në pjekje janë edhe :

LUFTIMI I BARËRAVE
TË KËQIJA

Prania e tyre në parcelë ka ndikim negativ për kulturën e grurit, si rezultat prania e tyre ul rendimentin në 15-20%. Rrugët e luftimit janë parandaluese (qarkullimet bujqësore), Kimike me spërkatje dhe mekanike të harrja me dorë rol të mirë luan edhe duke zgjedhur paraimën në qarkullimin bujqësor, paraimët prashitëse dhe kulturat bishtajore janë kulturat më të mira që e lënë tokën të pastër nga infeksioni nga barishtet e këqija

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

KULLIMI I TOKAVE BUJQËSORE DHE MASAT
QË MERRN PËR FUNKSIONIMIN E TIJ

Zhvillimi i bujqësisë intensive shoqërohet gjithmonë me një sistem kullimi funksional e cila lidhet direkt me garantimin e kullimit të tokave bujqësore dhe mbrojtjen e të mbjellave në periudha të ndryshme të vitit por sidomos në periudhën e lagësht të dimrit.

Infrastruktura e kullimit në vendin është ajo e ndërtuar ekzistuese dhe përbën një pasuri të madhe kombëtare. Kjo infrastrukturë e kullimit është projektuar dhe ndërtuar mbi bazën e kullimit me vetërrjedhje dhe atë me ngritje mekanike që janë hidrovoret.

Një tokë bujqësore e kulluar mirë është garanci për sigurinë e kultivimit të kulturave bujqësore të mbjella në vjeshtë, kulturave shumëvjeçare (jonxhë) dhe drurëve frutore. Kulturat bujqësore në varësi të llojit të tyre nuk durojnë dot një periudhë të gjatë lagështie përmbytje mbasi asfiksohet sistemi rrënjor i tyre duke riskuar prodhimin e pritshëm.

Aktualisht jemi në përfundim të fushatës së mbjelljeve të bimëve graminore dhe atyre foragjere e cila quhet e përfunduar dhe me hapjen e vijave kulluese dhe pastrimin e kanaleve të treta për të krijuar kushte optimale për mbirje dhe rritjen e bimëve të sapombira.

Vijat kulluese që hapen pingul me kanalet e treta dhe ndajnë ngastrat në "lehe" njësia më e vogël e sistemit dhe e punimit të tokës, shërbejnë për kullimin e ujërave të lehta dhe për t'i çuar në kanalim e tretë. Vija kulluese

ka funksion kullimin sipërfaqësor dhe nëntokësor. Ajo mbledh dhe çon në kanalet kulluese të ngastrës ujërat që rrjedhin në sipërfaqen e lehes, ujërat që rrjedhin nëpër kalimet e krijuara nga plugimi dhe nga shkruftimi i shtresës së punuar dhe në përgjithësi ujin që rrjedh nëpër makroporet deri në thellësi dhe largësi ku arrin efekti i saj.

Vijat kulluese hapen në largësitë 23-27-31m me thellësi më të madhe se plugimi i tokës 40 – 60 cm. Në praktikë dallojmë:

• Vija të cekëta deri në 30 cm dhe vija të thella deri në 60 cm rradhë herë më shumë,

• Vija të përkohshme që mbyllen kur bëhet plugimi dhe vija të përhershme që ruhen për disa vjet rresht.

• Vija të hapura me krah dhe vija të hapura me makineri, në rastet kur vijat hapen me krah gjerësia e poshtme bëhet aq sa kap lopata ose beli 30cm.

Në përgjithësi vijat mbyllen nëpërmjet plugimit dhe rihapen mbas plugimit, pra janë të përkohshme ose më saktë stinore. Për të lashtat ato hapen zakonisht mbas mbjelljes. Në këtë rast

duhet patur parasysh që dheu që gërmohet të hidhet sa më i shpërndarë.

Çfarë duhet patur parasysh nga
fermeri në këtë periudhë?

• Duhet ta ketë punuar tokën dhe ta mbajë atë të shkruftët, sistemin sipërfaqësor të jetë me orientim nga kanali kullues i tretë ose (terciar).

• Punimi i ngastrës sidomos në tokat e rënda të kryhet me sistem kurriz peshku, me qëllim që ujërat të kullojnë në të dy krahët e parcelës drejt kanalit kullues të tretë.

• Të mbajë pastër kanalet kulluese të tretë (KK – terciare) ose kanalet e ngastrave si detyrë e vet fermerit konform ligjit.

• Kokat e daljeve të kanaleve kulluese terciare të jenë të hapura dhe me pjerrësi drejt kanalit kullues sekondare (të dytë).

• Të kontrollojnë portat ose barazhet si dhe veprat e artit, tombino etj., për gadishmërinë e sistemit kullues në tërësi dhe për problemet e konstatuara të raportojë në Bordin e Kullimit dhe Bashkinë të cilës i përket.

• Sistemi i hapur kullues duhet të funksionojë i gjithë Unik mbasi bëhet shkak për përmbytje të përgjithshme d.m.th. Kanali Kryesor – funksional, Kanali sekondar – funksional i hapur dhe kanalet terciare të pastruara.

• Në rastet e tokave të drenazuara fermeri duhet të punojë tokën deri në thellësinë që nuk takon drenat. Kuota e kanalit terciar të jetë nën kuotën e shkarkimit të drenave.

• Fermeri duhet të jetë gjithmonë i informuar për situatën e reshjeve hidrometeorologjike mbasi kanalet kulluese janë ndërtuar me % sigurie, d.m.th që skema kulluese është e detyruar të pranojë edhe përmbytje kur tejkalohe ky nivel i rreshjeve të shiut.

• Në zonat kodrinore malore fermeri duhet të ketë parasysh shumë mirë KUL (Kanale e Ujërave të Larta) në raste rreshesh intensive mbasi ato sjellin shumë mbetje aluvionale për shkak të erozionit duke mbledhur rrëqetë dhe përrenjtë me saistra të mëdha dherash që depozitohen me pas në kanal ose dhe vërshojnë në tokat bujqësore.

Bashkëpunimi i ngushtë i fermerëve me Bordin e Kullimit, Drejtoritë e Bujqësisë në Bashki i paraprijnë funksionimit të skemës kulluese, mbrojtjen e tokës bujqësore të parcelave dhe ngastrave të mbjella dhe krijojnë një siguri për të mbjellat që kryhen në stinë e vjeshtës.

Drejtorja e Shërbimit të Tokës dhe Ujërave;
QTTB-Fushë Krujë: E-mail: qttbfushekruje@yahoo.com

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUIJË

CILAT JANË KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË PRODHUESI PËR TË NGRITUR NJË FERMË SHPENDËSH, SISTEMET E MBAJTJES DHE MENAXHIMI I TYRE

Shpendaria është një nga degët më të rëndësishme të blegtorisë në ekonominë e vendit tonë. Me intensifikimin e zhvillimit të blegtorisë kjo degë ka pësuar zhvillim në kapacitetet e saj prodhuese, duke bërë që prodhimi të jetë në nivele të kënaqshme për plotësimin e kërkesave në rritje të konsumatorit. Në këtë mënyrë mbarështimi i shpendëve përbën një sektor me rëndësi për ekonominë bujqësore shqiptare, e bashkë me të edhe zhvillimi i industrisë përpunuese për përmirësimin e furnizimit të popullsisë me mish shpendi dhe me vezë. Prandaj këto mbeten si përparësi të punës sonë për sigurimin e nevojave ushqimore të popullatës, për shkak edhe të kostos së leverdisshme që ka ky aktivitet.

Industria e shpendëve ka fituar eksperiencë dhe rritje të vazhdueshme gjatë 20 viteve të fundit. Sot përdoren linja hibride për vezë e mish me aftësi të larta prodhuese, teknologji të përparura të rritjes dhe me racione të balancuara. Ndër speciet e shpendëve që mbahen për qëllime ekonomike janë pulat, patat, rosat, gjeli i detit dhe më rrallë mbarështohen specje të tjera si fazani, pëllumbi, struci etj. Me shtimin e popullsisë në shumë vende të botës është rritur edhe numri i shpendëve shtëpiakë. Shpendët në vendet me zhvillim, në shumicën e rasteve, rriten në mënyrë ekstensive dhe gjysmë intensive, të cilëve u sigurohet një sasi e kufizuar ushqimi. Produktet e shpendëve janë një nga burimet proteinike më të rëndësishme për njeriun në të gjithë botën. Sot rreth 30 % e proteinave shtazore për konsum njerëzor vjen prej produkteve të shpendëve. Mishi i shpendëve ka vlera të konsiderueshme biologjike dhe ushqimore, ai ka tretshmëri dhe vlerë të lartë ushqyese. Shtimi i prodhimit të mishit të shpendëve në vend përbën një nga detyrat strategjike të MBZHR. Kjo detyrë do të arrihet nëpërmjet:

1- Shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese të vendit;

2- Rritjes së cilësisë së mishit sipas standarteve të sigurisë ushqimore;

3- Zhvillimit të qëndrueshëm të fermave blegtorale.

Formimi i modeleve të përshtatshme të prodhimit ka të bëjë me ngritjen e fermave demonstrative që aplikojnë rritjen ekstensive dhe gjysmë intensive të shpendëve. Për këtë është e domosdoshme të bëhen ndryshime në sistemin e rritjes dhe mbarështimit në përshtatje me ritmet e larta të zhvillimit, duke u shoqëruar me përdorimin e një sistemi strehimi dhe të ushqyerit racional. Të ushqyerit duhet të mbështetet në shfrytëzimin e burimeve ushqimore cilësore të kombinuara me koncentrate dhe përzierje mineralo-vitaminike, e shoqëruar kjo me kullotat natyrale që janë nga burimet potenciale të mëdha që duhen shfrytëzuar. Me kushtet e favorshme klimatike që kemi, mund të aplikojmë rritjen në sistemin e lirë, ose Free Range, për pulat e vendit duke e lidhur me ekoturizmin, por dhe mund të aplikojmë teknologji të veçanta për prodhime biologjikisht të pastra, të

cilat janë shumë të kërkuara në tregun evropian dhe kudo sot në botë.

Sistemet e mbajtjes në fermat e shpendëve

Në vendin tonë shpendët mbahen në 3 (tre) sisteme: sistemi ekstensiv, sistemi gjysmë intensiv dhe intensiv.

Sistemi ekstensiv: Ky sistem zbatohet në dy forma të thjeshta; mbajtja në oborret familjare dhe mbajtja e lirë e organizuar, që aplikohen kryesisht nga fermerët e vegjël ose pranë familjeve fshatare. Duhet të theksojmë se pjesa më e madhe e pulave në vendin tonë mbahet nga fermerët të vegjël dhe të mesëm në kushte ekstensive dhe gjysmë intensive. Këto mbajtje shkojnë në masën 80 % të numrit të përgjithshëm të tyre dhe mbarështimi bëhet duke u mbështetur në traditën shekullore të mbajtjes kryesisht në kullotë, ku shpendët sigurojnë një pjesë të mirë të nevojave për ushqime, por strehimet e tyre janë të papërshtatshme. Numri i krerëve për familje arrin 30 - 50 krerë dhe në disa raste 100 - 150 krerë. Rendimenti i tyre është i ulët, rreth 110 kokra vezë për pulë në vit, ku sigurojnë një pjesë të mirë të nevojave për ushqime.

Sistemi gjysmë intensiv: Ky sistem zbatohet në mbajtjen si brenda dhe jashtë stallës, pra në dy forma: stallë - kullotë dhe stallë - padok, ku madhësia e tufës shkon në 400 - 1500 krerë.

Sistemet gjysmë intensive përdoren zakonisht nga fermerët e vegjël dhe karakterizohen nga pajisja e një ose më shumë stallave të vogla, në të cilat zogjtë mund të konsumojnë ushqime të gjelbëra në natyrë dhe ushqime të koncentruara. Duhet të sigurohen të paktën 2 kapanone për përdorim alternativ, pra për të shmangur sëmundjet ndaj parazitëve. Teknologjitë e rritjes në këto dy sisteme kanë diferenca të theksuara, sepse prodhimi në sistemin ekstensiv është i ulët, rreth 110 kokra vezë për pulë, ndërsa në sistemin gjysmë intensiv, racat e pulave të drejtimit për vezë janë të kultivuara dhe japin rendiment të lartë vezësh. Ato prodhojnë rreth 260 - 280 deri 300 - 320 kokra vezë në vit për pulë, duke harxhuar rreth 2.1 - 2.3 kg ushqim.

Sistemi intensiv: Në sistemin intensiv shpendët mbahen në lokale të mbyllura, ku u sigurohen të gjitha kushtet e nevojshme për jetesë e prodhim si: mikroklima e përshtatshme, ushqimi, uji etj. Veçoritë e mbajtjes së shpendëve në sistemin intensiv dhe përparësitë e tij qëndrojnë në:

- Prodhimin e lartë të mishit;
- Kërkon pak sipërfaqe për mbajtjen e shpendëve;
- Ka rendiment të lartë e shkallë të lartë

mekanizmi;

- Përdorimin e ushqimeve më të balancuara;
- Marrjen e masave rigorozë për parambrojtjen nga sëmundjet;
- Përdorimin e hibrideve me aftësi të larta prodhuese;
- Prodhimi nuk varet nga stina.

Çfarë kriteresh duhet të plotësojë prodhuesi për të ngritur një fermë shpendësh?

1. Të përcaktohet drejtimi i fermës (e integruar apo e specializuar)

Në varësi të kushteve të fermës, kërkesave të tregut dhe madhësisë së biznesit (mundësi për investime) mund të vendoset: nëse ferma do të jetë e specializuar vetëm për një drejtim p.sh. për vezë ose për mish, apo një fermë me cikël të mbyllur d.m.th. që nga prindërit e deri tek linjat e përpunimit të produkteve dhe nënprodukteve.

2. Të përcaktohet specia

Prodhuesi duhet të vendosë nëse do të merret me mbarështimin e pulave për vezë, për mish, të kombinuara mish - vezë, të pulave të detit, patave, rosave etj.

3. Të përcaktohet vendodhja e saj

Synimi i çdo aktiviteti është fitimi. Është pikërisht ky faktori kryesor që mbahet parasysh kur vendosim se cili rajon (vend) na jep mundësinë, që biznesi të jetë i suksesshëm në lidhje me tregun. Faktorët që mbahen parasysh në përcaktimin e vendit të ngritjes së aktivitetit janë:

- Mundësia për të siguruar lëndën e parë (zogj ose vezë);
- Kërkesa dhe afërsia me tregun;
- Fuqia punëtore;
- Mundësia për të siguruar ushqime (lëndë të para apo produkt të gatshëm);
- Kushtet klimatiko - tokësore;
- Superioriteti arsimor - profesional dhe promocional, që ofrohet për të përballuar konkurrencën nga fermat me të njëjtin aktivitet prodhues.

4. Të përcaktohet madhësia e fermës

Eksperienca ka treguar se shumë pulari nuk japin fitim të kënaqshëm për faktin se janë shumë të vogla në numër. Një person që vendos të sigurojë jetesën e tij vetëm nga një pulari duhet të ketë një tufë relativisht të madhe shpendësh, por edhe duhet të parashikojë një risk po aq të madh. Studime të shumta ekonomike kanë treguar se pothuajse të ardhurat neto nga një aktivitet i tillë është në koleracion të fortë

me madhësinë e tufës. Natyrisht, ky fakt ka edhe anën tjetër të medaljes, kur ndodh që në një vit të keq, sa më e madhe të jetë tufa, aq edhe më të mëdha do të jenë humbjet e mundshme. Gjithashtu, duhet theksuar se një fermë të tillë i duhet një administrim dhe staf teknik profesional.

Kjo pikë meriton të theksohet:

- Së pari: madhësia është një prirje e kohës në aktivitetin e shpendërit; Madhësia e një ferme varet nga dy faktorë:
 1. Aftësia e personelit drejtues të saj;
 2. Perfeksioni teknologjik.
- Së dyti: metoda më e thjeshtë për të shpëtuar nga falimentimi i një biznes të rritjes së shpendëve është rritja e madhësisë së tij.

5. Menaxhimi i fermave të shpendëve

Menaxhimi i zogjve lidhet me një mbarështim të ushqyer sa më të mirë dhe me gjendje optimale shëndetësore, për rritjen e prodhimit, por edhe duke i paraprirë sigurimit të mikroklimës dhe zbatimit të masave efikase të profilaksisë e të biosigurisë. Kjo teknologji ka për qëllim t'i vijë në ndihmë fermerëve, duke zbatuar teknologjinë e rritjes dhe të ushqyerit të zogjve, për arritjen e performancave të larta. Teknikat e menaxhimit që përbahen në këtë teknologji janë konsideruar si më të përshtatshmet për ruajtjen e shëndetit dhe mirëqenien e mirë të zogjve. Prandaj, sot është e domosdoshme ngritja e nivelit të fermave familjare në zbatimin e këtyre teknologjive bashkëkohore, me synim rritjen e prodhimit të mishit dhe të vezëve me kosto sa më të ulët dhe për të përballuar kështu edhe konkurrencën e importit. Ndërmarrja e këtij projekti justifikohet me studimin e gjendjes aktuale, futjen e teknologjive të mbarështimit të ushqyerit, duke krijuar kushte të përshtatshme për strehim dhe duke i trajtuar shpendët me racione ushqimore të balancuara me qëllim që të përmirësohen treguesit produktivë dhe të rritet leverdisshmëria e mbajtjes së tyre për vezë dhe mish. Duke parë që nga pikëpamja racore shpendët në aktivitetin familjar janë gati të përmirësuar dhe me prodhim sezonal është e rëndësishme që ne t'i mbështesim këto fermerë, duke iu ofruar teknologji të përshtatshme për mbarështimin e shpendëve dhe mënyrës së menaxhimit të fermës së tij, në drejtim të përkujdesjes, radhës së aktiviteteve dhe kontrollit të vazhdueshëm.

Si përfundim:

Treguesit esenciale për të pasur një biznes të suksesshëm në shpendari janë:

- Raca e shpendëve;
- Ushqimi dhe të ushqyerit;
- Drejtimi tekniko-administrativ i suksesshëm;
- Profilaksia veterinarë;
- Mbajtja me kujdes e dokumentacionit.

NJË MENAXHIM I MIRË ËSHTË KYÇI I SUKSESIT TË ÇDO BIZNESI!

Specialiste: Dallandyshe Peti

Drejtorja e Teknologjive Blegtorale, QTTB-Fushë Krujë:
E-mail: qttbfushekrue@yahoo.com

KËNDI I EKSPERTIT

Kalendari bujqësor, muaji janar 2023

Përgatitur nga Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari

Agimi më i vonshëm i muajit në Tiranë, do të jetë ora 7:06 e mëngjesit të datës 4 janar dhe lindja më e hershme do të jetë 14 minuta më herët në orën 6:53 të mëngjesit të 31 janarit.

Pamja e qiellit gjatë muajit janar 2023

Më 3, 4 janar - Dushi meteorësh kuadrantidësh. Kuadrantids është një shi mbi mesataren, me deri në 40 meteorë

Parashikimi i motit për muajin janar 2023 në Tiranë (Zona bregdetare)

Dt.	Temperatura e ajrit °C		Temp. reale që ndjehet °C	Shiu		Era				UV Indeks	Zhvillimi i reve dhe reshjet	Simboli		
	U	L		mm	Orë	Km/Orë	Drejtimi		D				N	
1	3	11	3/12/2011	0	0	7	4	L	LVL	1	Kryesisht me re			
2	2	12	3/14/2012	0	0	7	2	L	L	2	Pas largimit të reve kthehet dielli			
3	2	13	3/15/2013	0	0	6	4	LVL	VL	2	Pjesërisht me diell			
4	3	13	3/14/2014	0	0	6	4	L	JL	1	Shtimi i vranësirës			
5	5	13	5/13/2012	0	0	7	6	LJL	L	1	Kohë me re			
6	5	12	5/12/2012	0	0	7	4	L	L	1	Kryesisht me re			
7	6	14	6/14/2013	1.4	2.5	9	6	L	LJL	1	Një shi i vogël në mëngjes pastaj vranësirë e madhe			
8	7	12	6/12/2011	1.1	1.5	9	7	LJL	JL	1	Kryesisht me re			
9	6	13	6/13/2012	1.1	1.5	7	7	L	LVL	1	Re, një shi me pika në mëngjes i ndjekur nga një shi i vogël pasdite			
10	6	13	7/14/2013	0	0	7	6	VL	V	1	Kryesisht me re			
11	4	14	-30	0	0	9	13	VL	VVL	1	Kohë me vranësira dhe diell			
12	3	12	2/10/2008	0	0	19	9	VL	VL	2	Pjesërisht me diell			
13	2	11	1/13/2010	0	0	7	11	V	VVP	2	Kohë me vranësira dhe diell			
14	6	11	6/12/2010	0	0	9	6	P	JP	2	Diell i pjesëshëm			
15	6	12	3/15/2013	0	0	6	11	JP	JJP	2	Periudhë me vranësira dhe kohë e mirë			
16	7	13	1/11/2010	1.3	2	19	24	JJP	JJP	1	Vranësirë e konsiderueshme			
17	3	15	-29	11.6	7.5	26	24	JP	PJP	1	Kohë me re dhe reshje			
18	2	15	-25	10.2	6.5	19	13	P	VVP	1	Kohë me re dhe reshje			
19	2	12	-25	0	0	9	7	VVP	VL	2	Pjesërisht me diell			
20	3	11	-21	1.5	2	19	28	LVL	LVL	2	Kohë me vranësira dhe diell			
21	2	11	-20	2	1.5	33	39	LVL	VL	1	Kohë me re dhe me erë			
22	2	11	-18	2.9	2.5	0.6D	4.5	30	24	VL	VVL	1	Vranësira dhe erë me reshje shiu dhe bore herë pas here duke u shndërruar në shi	
23	2	11	-19	0	0	24	22	VL	LVL	2	Periudhë me vranësira dhe diell			
24	2	11	-23	0	0	17	20	LVL	LVL	2	Kohë me diell dhe njolla resh			
25	3	11	-21	0	0	19	20	L	L	2	Pjesërisht me diell			
26	3	12	-23	0	0	17	19	L	L	2	Kryesisht me diell			
27	3	12	-23	1.7	2	19	22	L	L	3	Diell i pjesëshëm			
28	3	12	-24	0.8	1	19	20	L	LVL	2	Reshje të herëpashershme të shiut në mëngjes; pastaj mjaft me re			
29	3	12	-22	0	0	24	30	LVL	LVL	3	Kryesisht me diell			
30	3	13	-21	0	0	24	24	L	L	3	Kryesisht me diell			
31	3	12	-23	5.3	3	22	24	L	L	3	Kohë me vranësira dhe diell			

Parashikimi i motit për janar 2023 në Korçë (Zona e ftohtë)

